



R A P O R T

**PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

Tiranë, 2012





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË
LARTË PUBLIKE, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT I AUDITIMIT TË LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE

Titulli i raportit dhe subjekti: "Mbi zbatimimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues" në Institucionin e Avokatit të Popullit".

Muaji i përgatitjes së raportit: Nëntor 2012

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 883 / 1 prot., datë 19/ 07/ 2012.

Auditimi është kryer nga :

- | | | |
|------------|--------|-------------------|
| 1.Vasil | VANE, | përgjegjës grupi, |
| 2.Qeram | CIBAKU | anëtar |
| 3.Raimondi | KOCI | anëtar |
| 4.Olijana | IFTI | anëtar |

Auditimi ka filluar më 19/ 07/ 2012.

Auditimi ka përfunduar më 28/ 09 /2012.

Peridua e audituar: 01 01.2011- 30.06.2012

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi aktivitetin e **Institucionit të Avokatit të Popullit Tiranë** (këtu e në vazhdim A.P.)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive.....	Faqe 3-7
Hyrje.....	Faqe 8
Qëllimi, Metoda dhe Procesi i auditimit.....	Faqe 8-9
Rezultatet e auditimit.....	Faqe 9-37
1. Rezultatet e auditimit të zbatimit rekomandimeve.....	Faqe 9-10
2. Vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	Faqe 10-15
3. Auditimi i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit.	Faqe 15-19
4. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet.....	Faqe 20-25
5. Mbi administrimin e pronës shtetërore, zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen dokumentimin e vlerave monetare e materiale.....	Faqe 25-28
6. Drejtimit e auditimit për Prokurimet.....	Faqe 28 -37
7. Rekomandimet.....	Faqe 37 -39



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

PËRMBLEDHJA

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditor aktivitetin e Institucionit të Avokatit të Popullit Tiranë (këtu e në vazhdim A.P.), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit. Objektivi kryesorë ka qenë dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e zbatimit të buxhetit, funksionimit e sistemeve të menaxhimit financiar, të kontrollit, organizimit dhe të funksionimit Institucionit.

Bashkëpunimi me stafit e Institucionit të Avokatit Popullit gjatë auditivit ka qenë i frytshëm, si për të ballafaquar gjetjet e konstatuara nga auditivi ashtu dhe zbatimi i standardeve të aktivitetit. Kemi diskutuar opinionet dhe konkluzionet tona duke i reflektuar në raport dhe në rekomandimet e lëna, që synojnë përmirësimin e kuadrit rregullatorë me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efijences në menaxhimin financiar dhe përmirësimin e performances.

Grupi i auditimit ka përdorur metodën grafike e tabelore për pasqyrimin e treguesve dhe ecurisë në vite, me qëllim vlerësimin e performancës së këtij subjekti të audituar.

Më poshtë po japim të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet kryesore të rezultuara gjatë auditivit.

- Në lidhje me zbatimin e afatit ligjor 20- ditësh për **kthimin e përgjigjes** për rekomandimet e bëra për përmirësimin e gjendjes nga KLSH vërehet se nga ana e Institucionit të Avokatit Popullit është kryer analiza përkatëse dhe janë marrë vendimet përkatëse. Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 1, datë 06.01.2011, është miratuar krijimi i njësisë së prokurimit.

- Në lidhje me programet e hartuara nga subjekti për zbatimin e masave dhe rekomandimeve të dërguara me shkresën e sipërcituar dhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, u konstatua se A.P ka hartuar "**Programin e masave për zbatimin** e rekomandimeve të KLSH-së, për kontrollin e aktivitetit ekonomiko-financiar" sipas shkresës nr. 72/4 prot., datë 20.07.2011. Ky plan është hartuar duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe persona përgjegjës për zbatimin e tyre.

Në drejtim të Vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga auditimi i KLSH vërehet se:

Strukturat përgjegjëse të Avokatit të Popullit, kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Nga auditimi në vend i praktikave, sipas kërkesave të këtyre akteve sa sipër, konstatohet se:

-Me shkresën nr 156/1 date 17.11.2011), është **Caktuar Nëpunësi Autorizues**, ish-Sekretari i Përgjithshëm i A.P .

- Nga ana e institucionit të A.P është përgatitur "**Deklarata Vjetore mbi Funksionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar për vitin 2011**".

- Nga misioni i auditimit vërehet se Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm është **dorëzuar me 26 ditë vonësë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

-Institucioni i Avokatit Popullit ka përgatitur "**Raporti Vjetor i Funkcionimit të SKB & MF për vitin 2011**", në përgjigje të kërkesave të shkresës së NJQHMFK në MF nr. 24327, datë 30.12.2011.

-Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, vlerësojmë se vlerësimet e SKB & MF janë kryer me pikë (1 deri 3), por në mjaft raste nuk janë shoqëruar me përgjigjet (komentet respektive), siç cilësohet në kriteret e Kapitullit III, Hapi III, kreu "Procesi i Implementimit të MFK", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

- Misioni i auditimit vëren se *nuk janë hartuar* gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emetuara nga Ministria e Financave dhe rrjedhimisht, *nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme*, veprime këto në mospërbushje të kërkesave të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

Një vend i veçantë ju kushtua vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe vlerësimit të efektivitetit të tij në realizimin e performancave të këtij subjekti publik.

Kjo mangësi është korrigjuar me Urdhrin e Brendshëm të Avokatit të Popullit, nr. 85, datë 31.08.2012.

- Audituesit e KLSH-së konstatojnë se **nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve**, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296 "Për MFK", i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2011, nga çdo njësi publike si dhe të dërgimit të regjistrit të risqeve në NJQHMFK të MF.

- Ndonëse janë marrë disa masa paraprake, (janë identifikuar 2-3 risqe), vërehet se *menaxhimi i risqeve pothuajse është fushë e pa hulumtuar, por lypset që menaxhimi të hartojë një strategji për këtë çështje.*

- Auditimi konstaton se nuk ka një regjistër risqesh, si dhe as një sistem të rishikimit dhe përditësimit të tij. Përveç sa më sipër, A.P nuk ka të evidentuar, si rrjedhim as të analizuar ato, me qëllim menaxhimin e tyre dhe minimizimin e pasojave të tyre në zhvillimet e ardhshme.

- Nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën objekt auditimit **nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve**, detyrimi i nenit 8/a, 10, 11 dhe 21 të ligjit nr. 10296.

- Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton **një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.**

- Institucioni i Avokatit Popullit, disponon një **Rregullore të Brendshme të Punës**, e aprovuar me Urdhrin nr. 64, datë 28.05.2008 të Avokatit të Popullit, ku janë përcaktuar detyrat për aparatin dhe punonjësit e tjerë **kjo rregullore nuk reflekton detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10296**, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kërkesat e shkresës së Ministrisë së Financave nr. 6082, datë 16.03.2011, "Për hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike për implementimin e ligjit nr. 10296", që specifikon rishikimin e strukturave menaxheriale për të reflektuar; përgjegjshmërinë menaxheriale, linjat e raportimit, rastet e delegimit të drejtave dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

detyrave, procedurat standarde për menaxhimin e aktiveve; procedurat e brendshme antikorruption si dhe sinjalizimit të parregullsive, në reference të nenit 8, germa "ë", të ligjit nr. 10296.

Sa më sipër **rekomandojmë**.

- Në zbatim të neneve 10 dhe 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08. 07. 2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Institucioni i Avokatit Popullit të identifikojë risqet, të hartojë Regjistrin dhe Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve dhe të zhvillojë një procedurë efikente për evidentimin, analizën dhe menaxhimin e risqeve, sipas prioriteteve dhe drejtimeve.

- Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, etj.

- **Rregullat mbi komunikimin dhe raportimin midis strukturave drejtuese nuk janë të shkruara për të përcaktuar këto marrëdhëniet dhe hierarkinë e raportimit, informimit, thirrjes, procedurat, afatet etj., për të cilat duhen ndërmarrë veprime korrigjuese.**

- Në institucionin e A.P , ka një sistem monitorimi i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis administratës, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtorëve dhe përgjegjësive të sektorëve; personelit, financës dhe protokollit, teknologjisë së informacionit, etj, për mbikëqyrjen e sektorëve që mbulojnë.

- Çdo transaksion financiar kontrollohet nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Mirëpo, **ky sistem nuk është i pasqyruar në Rregulloren e Brendshme.** Sa më sipër **rekomandojmë**.

- Të rindërtohet organigrama e organizimit dhe funksionimit të institucionit të Avokatit Popullit ballafaqur me kërkesat dhe përgjegjësitë e kreut II, neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit" të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

- Auditimi vëren se raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore i janë paraqitur periodikisht MF, ndërsa raporti i monitorimit 12 mujor është dërguar me shkresën nr. 11, datë 09.01.2012.

- **Auditimi vëren se mungon një rregullore pune në komunikimet elektronike dhe në kuadër të implementimit të informatizimit të veprimtarisë, për kriteret dhe raportet në shqyrtimin dhe përpunimin e informacionit të disponuar.**

Sa më sipër **rekomandojmë**.

Të punohet për përgatitjen e një rregulloreje pune në komunikimet elektronike dhe në kuadër të informatizimit të veprimtarisë, për kriteret dhe raportet në shqyrtimin dhe përpunimin e informacionit.

- Nga kontrolli për zbatimin e kriterëve dhe kompetencave për transferimin e fondeve buxhetore rezultoi se, transferimi i tyre në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, është bërë në përputhje me udhëzimet e mësipërme.

- Nga auditimi dhe verifikimi i **sistemit të pagave** dhe shtesave mbi to, për periudhën objekt auditimi , konstatohet se veprimet e përlogaritjes së tyre janë në mbështetje të VKM nr. 475, datë 13.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë....", i ndryshuar dhe VKM nr. 500, datë 18.07.2003 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Avokatit të Popullit", por për punonjësit e IT nga ana e institucionit nuk është marrë konfirmimi përkatës për shtesën e dhënë në masën 15 % pranë këtyre autoriteteve shtetërore.

Sa më sipër **rekomandojmë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Ti kërkohet Departamentit të Administratës Publike konfirmim mbi dhënien e shtesës mbi pagë në masën 15 % për punonjësën e IT, sipas detyrimit të pikës 4/1, të VKM nr. 545, datë 11.08.2011.- Auditimi vëren se janë plotësuar rubrikat e vlerësimit vjetor të punonjësve për vitin 2011 sipas seksioneve dhe stafit mbështetës.

- Blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla të likuiduara me pagesat e arkës, janë kryer në përputhje me VKM nr 1, datë 10.01.2007.

- Ende nuk janë hartuar nga institucioni (dhe rrjedhimisht mungon miratimi nga titullari) i **Rregullave dhe procedurave për mbrojtjen e aseteve**, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa "ç" të ligjit nr. 10296.

- Është hartuar **regjistri i aseteve**, detyrim i paraparë nga kreu III, pika 26 e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Janë iniciuar **procedurat e inventarizimit të pasurisë dhe të drejtave e detyrimeve** 1 herë në vit, sipas urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 54, datë 05.12. 2011.

Sa më sipër **rekomandojmë**

- Institucioni i Avokatit Popullit, të marrë masa për të hartuar e aprovuar procedurat përkatëse mbi administrimin material të aktiveve, inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, etj.

- Auditimi konstaton se është hartuar **Kodi Etik** dhe është miratuar nga Avokati i Popullit z. Igli Totozani, për këtë njësi të qeverisjes së përgjithshme të audituar, me Urdhrin e Brendshëm nr. 29/1, datë 02.05.2012. Ai është titulluar "Kodi i Sjelljes së mirë administrative në institucionin e A.P".

Institucioni i Avokatit Popullit ka vendosur një sistem elektronik për evidentimin e aseteve dhe vlerave materiale fizike.

- Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiar edhe të dispozitave ligjore në fuqi dhe mbi këtë bazë janë përcaktuar objektivat e sektorit përkatës për një ndjekje sistematike dhe operative të shpenzimeve buxhetore në përputhje me detyrat e përcaktuara

- Blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla të likuiduara me pagesat e arkës, janë kryer në përputhje me VKM nr 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nga një komision i ngritur me Urdhrin e Brendshëm të Avokatit nr 07, datë 13.01.2011 për vitin 2011 dhe Urdhrin e Brendshëm të Avokatit nr 11, datë 17.01.2012, nr. 44, datë 18.05.2012 për vitin 2012.

- **Gjatë procedurave për plotësimin e nevojave me punë, shërbime e mallra** nëpërmjet prokurimit publik, gjatë vitit 2011 nga auditimi janë konstatuar **disa mangësi si më poshtë:**

- Argumentimi i nevojave për karburant, riparimin e automjeteve dhe blerje kompjutrash, është bërë nga përgjegjësi i administratës si për vitin 2011, ashtu dhe për vitin 2012.

Nevojat për punë, mallra e shërbime **nuk janë bërë sipas sektorëve e specialisteve të sektorëve, duke u mbështetur në argumente, dokumentet , normativa konsumi dhe kostove për njësi.**

- Njësia e prokurimit e ngritur me Urdhrin e Brendshëm Nr.1, datë 05.01.2011, nuk ka qenë i plotë mungon emri i juristit që do jetë në përbërje të kësaj njësie prokurimi dhe janë konstatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

mangësi gjatë funksionimit pasi ne urdhrat e prokurimit nuk është përcaktuar personi përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit të prokurimit.

- Janë konstatuar, mangësi ne funksionimin e njësisë se prokurimit, pasi jane nxjerre urdhra te prokurimit te cilet nuk permbajne elementet perberes sikurse përcaktohet në ligjin e prokurimeve dhe dispozitave zbatuese.

Raporti përmbledhës i prokurimit me objekt "Blerje Karburanti", i datës 03.03.2011, megjithëse është përgatitur, nuk është miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor, ky mosveprim përben shkelje: të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Të tre dosjet e dokument të procedurave të prokurimit të kryer në vitin 2011, *nuk janë dorëzuar në arshivë me protokoll, të inventarizuara nga njësia e prokurimit, sipas Udhëzimit e APP e DST.*

- Dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të protokolluara dhe të arshivuara nga njësia e prokurimit.

Sa më sipër **rekomandojmë.**

- Të realizohet dokumentimi i plotë i dosjeve të prokurimeve të inventarizohen ato dhe të bëhet dorëzimi i tyre me procesverbal në arshivën e institucionit.

- Pagesat për Shërbimet e automjeteve janë kryer pa hartuar më parë preventivin e punimeve e shërbimeve që do të kryheshin tek automjetet e paraqitura në oficinën e subjektit, e përcaktuar kjo në nenin 8 " Kushtet e Pagesës " të DST.

- Nuk janë dorëzuar në magazinën e institucionit pjesët e këmbimit të përdorura së bashku me mallrat, për tu magazinuar duke mos zbatuar kështu nenin 10, pika 10,3, "Pjesë e Këmbimit" të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

- Autoriteti kontraktor nuk ka ngritur një komision si për hartimin e preventivave për riparimin e automjeteve dhe shërbimet që do kryhen në to, ashtu dhe proces verbal të marrjen në dorëzim të punimeve e shërbimeve të kryera nëpër automjete, sipas DST.

- Situacionet e punimeve që janë kryer për riparimin e automjeteve, janë firmosur vetëm nga kontraktori , pa pjesëmarrjen dhe firmën e përfaqësuesve të autoritetit kontraktor të cilët e kishin detyrim ligjor të hartonin preventivin e riparimeve dhe shërbimeve që do të kryheshin në çdo automjet sipas përcaktimit të "Dokumentit Standard të Tenderit"

- Nuk ka emërim me shkrim, në vitin 2011, të një personi ose post organizativ që do të ndjekë çështjen e ekzekutimit të kontratës, mos caktimi i një personi për ekzekutimin e kontratës, përben shkelje të Nenit 31, "Përfaqësimi i Palëve" të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST).

Sa më sipër **rekomandojmë.**

Të trajnohen nga APP personat e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor për të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve elektronike.

Duhet theksuar se: në vitin 2012, janë bërë përmirësime në organizimin dhe funksionimin e njësive prokurimit dhe komisionit vlerësimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Hyrja

Nga data 19.07.2012, deri më datën 28.09.2012, grupi i auditimit i përbërë nga kontrollorët Vasil Vane, Qeram Cibaku, Rajmond Koçi dhe Oliana Ifti, auditoi mbi veprimtarinë e Institucionit të Avokatit Popullit.

Përshkrimi i çështjes që auditohet është zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, në drejtim të programimit dhe zbatimit të buxhetit nga institucioni i Avokatit të Popullit duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit.

Gjatë auditimit të kryer u konstatua se përveç rezultateteve pozitive të evidentuara në këtë raport, janë identifikuar edhe mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar për të cilat janë trajtuar me hollësi në Raportin e Auditimit.

Për zbatimin e auditimit u mbështetëm në dispozitat ligjore si më poshtë.

Ligji nr. 8270, datë 23. 12. 1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar, me Ligjin nr. 8599, datë 01. 06. 2000. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij, Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjet për buxhetin e viteve përkatëse objekt auditivi si dhe udhëzimet për zbatimin e tij në vitet përkatëse, Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" I ndryshuar, Akte Normative që rregullojnë sistemin e punës dhe të pagave etj

QËLLIMI DHE PROCESI I AUDITIMIT:

Subjekti i audituar: Institucioni i Avokatit Popullit.

Çështjet e audituara :

- Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në kontrollin e mëparshëm.
- Vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Auditimi i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet.
- Mbi administrimin e pronës shtetërore, zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin,

ruajtjen dokumentimin e vlerave monetare e materiale. Drejtimit e auditimit për Prokurimet.

Objektivat e auditimit synojnë në dhënien e opinionit në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë, rregullaritetin e transaksioneve të kryera nga strukturat përkatëse të Avokatit të Popullit e zbatimin e kërkesave të kuadrit rregullator ligjor të menaxhimit të sistemit buxhetor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

REZULTATET E AUDITIMIT:

1. AUDITIMI I ZBATIMIT TË DETYRAVE TË LËNA NË KONTROLLIN E MËPARSHËM.

Nga ana e KLSH janë dërguar përfundimet e kontrollit të fundit me shkresën nr. 221/5, datë 19.07.2011, që janë protokolluar në Institucionin e Avokatit Popullit me Nr. 72/4, prot., datë 20.07.2011.

Në bazë të autorizimit nr. 883/1, prot., datë 19.07.2012, të lëshuar nga Kryetari i KLSH për kontrollin e zbatimit të rekomandimeve, është kryer një verifikim, për zbatimin e këtyre rekomandimeve nga KLSH dhe është mbajtur akt-verifikimi Nr. 1, datë 24.09.2012.

Nga grupi i auditimit u rishikua ecuria e këtyre rekomandimeve deri në datën e kryerjes së këtij auditimi dhe rezultoi se:

I. - Në lidhje me zbatimin e afatit ligjor 20- ditësh për **kthimin e përgjigjes** për rekomandimet e bëra për përmirësimin e gjendjes nga KLSH vërehet se nga ana e Institucionit të Avokatit Popullit është kryer analiza përkatëse dhe janë marrë vendimet përkatëse. Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 1, datë 06.01.2011, është miratuar krijimi i njësie së prokurimit.

Për sa sipër, është zbatuar detyrimi i përcaktuar në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1987 me ndryshimet, për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor të sipërcituar, janë hartuar programet e masave, sipas afateve kohore të përcaktuara dhe urdhrat përkatës për realizimin e rekomandimeve.

Në Urdhrin e Brendshëm Nr.1, datë 06.01.2011, **nuk është përcaktuar juristi që është i detyrueshëm në përbërjen e njësisë së prokurimit dhe përgjegjësi i njësisë së prokurimit.** Mos emërimi i juristit dhe përgjegjësit të njësisë së prokurimit përben shkelje të VKM Nr. 1, datë 10.01.2006, Kreu V, "Zhvillimi i Procedurave", pika 1, ku shprehet se: **Në përberjen e njësisë së prokurimit, e cila përbëhet nga 3 persona me arsim të lartë, ku njeri prej tyre duhet të jetë jurist dhe sipas pikës 4, gërmesë i.), "Hapja dhe vlerësimi i ofertave",** ku shprehet se: Njeri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit të prokurimit dhe tekstit përfundimtar të tij.

Me Urdhrin e Brendshëm të Titullarit të Institucionit me Nr. 18, datë 26.01.2012, **është krijuar njësia e prokurimit e përbërë nga Arlind Kruja, jurist dhe përgjegjës i njësisë së prokurimit,** Dolorez Myrtezai, anëtare Merita Sanxhaku anëtare dhe Hajredin Hysa anëtarë.

- Për vitin 2012, njësia e prokurimit ka qenë e plotësuar me organikë të plotë e të përcaktuara në VKM Nr. 1, datë 10.01.2006, Kreu V, "Zhvillimi i Procedurave", pika 1.

II.- Në lidhje me programet e hartuara nga subjekti për zbatimin e masave dhe rekomandimeve të dërguara me shkresën e sipërcituar dhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, u konstatua se nga A.P ka hartuar **"Programin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, për kontrollin e aktivitetit ekonomiko-financiar"** sipas shkresës nr. 72/4 prot., datë 20.07.2011. Ky plan është hartuar duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe persona përgjegjës për zbatimin e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

2. Vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga auditimi i KLSH vërehet se:

Strukturat përgjegjëse të Avokatit të Popullit, kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Nga auditimi në vend i praktikave, sipas kërkesave të këtyre akteve sa sipër, konstatohet se:

2.1. Me shkresën nr. 156 /1, datë 17.11.2011, është **Caktuar Nëpunësi Autorizues**, ish-Sekretari i Përgjithshëm i A.P , sipas detyrimeve të nenit 74 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesave të shkresës së Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave nr. 20606, datë 31.10.2011 "Për caktimin e nëpunësve autorizues në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", ku specifikohet se **"Titullarët e njësive... të caktojnë Nëpunësin Autorizues të njësisë publike, Nëpunësit Autorizues të Nivelit të Dytë dhe të njoftojnë Nëpunësin e Parë Autorizues në Ministrinë e Financave brenda muajit nëntor të këtij viti"**. Gjithashtu, me shkresën nr. 31, datë 08.02.2011 dhe nr. 20, datë 17.01.2012 të AP, i janë njoftuar Degës së Thesarit depozitimi i nënshkrimeve për nëpunësve autorizues dhe zbatues (firma e I dhe e II-të), për ndryshimet e mëvonshme.

2.2. Nga ana e institucionit të A.P është përgatitur **"Deklarata Vjetore mbi Funksionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar për vitin 2011"**. Ky dokument është nënshkruar nga z.Gëzim Leshi dhe i është përcjellë Ministrisë së Financave, me shkresën nr. 96, datë 26.03.2012 dhe në bazë të përgjegjësisë të ligjit nr 10296, përkatësisht:

"Neni 18, Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm:

1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, **jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual**. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji"., dhe cilësimeve të kreut III, pika 3. 3 e Manualit PMFK

Nga misioni i auditimit vërehet se Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm është dorëzuar me 26 ditë vonesë.

Me anë të një shkrese të Ministrisë së Financave nr 23404 /82, datë 16.03.2012 për rikujtesë mbi përmbushjen e kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 10296, njësisë së qeverisjes së përgjithshme Avokati i Popullit, **i është vendosur një afat kohor tjetër për paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, deri në datën 26 mars 2012**. Ky afat është firmosur nga Nëpunësi i Parë Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave) dhe nga ky institucion është respektuar si më sipër, por ky afat i rivendosur del mbi ligjin e miratuar. Për sa mësipërm, konstatohet se është realizuar **me vonesë**, detyrimi i pikave nr. 4 dhe 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

15.12.2011, që përcaktojnë se *"deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave"*

Pra, nga ana e A. P., është përgatitur **"Raporti Vjetor i Funksionimit të SKB & MF për vitin 2011"**, në përgjigje të kërkesave të Shkresës së NJQHMFK në MF nr. 24327, datë 30.12.2011, *"Dërgohet për plotësim raporti dhe pyetësi për vlerësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Financave"*.

Nga analiza e hollësishme e këtij dokumenti vërejmë se:

-a.- Ky raport është përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

-b.- Nga analiza e rubrikave të plotësuar të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, vlerësojmë se vlerësimet e SKB & MF janë kryer me pikë (1 deri 3), por në mjaftë raste nuk janë shoqëruar me përgjigjet (komentet respektive), siç cilësohet në kriteret e Kapitullit III, Hapi III, kreu "Procesi i Implementimit të MFK", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010 *"Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*.

-c.- **Këto deklarime kanë rrjedhur nga shqyrtimi dhe analiza e Pyetësorit të Vetëvlerësimit mbi funksionimin e SMF dhe KB për vitin, në përgjigje të shkresës së MF nr. 23404 /1, date 15.12.2011 dhe rikujtueses mbi detyrimet e nenit 18 të ligjit nr. 10296 (shkresa nr. 23404 /82, datë 16.3.2012).**

Në vlerësimet e kryera në Raportin Vjetor mbi cilësinë dhe gjendjen e komponentëve të kontroleve të brendshme, analizohet se ai reflekton detyrimet e UMF nr. 28 / 2011, pika 16 dhe 17 si dhe Manualit MFK. Theksojmë se në pikën 17 të UMF nr. 28 / 2011, përcaktohet shprehimisht se: *"Raporti duhet të strukturohet sipas formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi, i cili përbehet nga:*

Përmbledhja ekzekutive;

Vlerësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë;

Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;

Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimin për të ardhmen;

Rekomandime të përgjithshme për Ministrinë e Financave lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit". Për sa sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e pikës 17, germa "c" të Udhëzimit të MF nr. 28, datë 15.12.2011, mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".

2.3. Misioni i auditimit vëren se nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emetuara nga Ministria e Financave dhe rrjedhimisht, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, veprime këto në mospërmbushje të kërkesave të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 10296 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe të detyrimeve të kapitullit III të *"Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, datë 15.07.2010. Kjo kërkesë është detyrim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

dhe i kreut I, pika 1 të Udhëzimit të MF nr. 28, datë 15.12.2011 për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin e mëparshëm buxhetor.

2.4. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin Regjistrin të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296 "Për MFK", i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2011, nga çdo njësi publike si dhe të dërgimit të regjistrin të risqeve në NJQHMFK të MF. *Pra, mungon një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve, ku të adresohen personat përgjegjës për çdo risk, konform caktimeve të kreut III të Manualit, "Identifikimi i rrisqeve". Ky fakt i ngarkon me përgjegjësi ish-Nëpunësin Autorizues të Avokatit të Popullit.*

2.5. Nga ana e Institucionin të Avokatit të Popullit për periudhën objekt auditimit *nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Rrisqeve*, detyrimi i nenit 8/a, 10, 11 dhe 21 të ligjit nr. 10296.

2.6. Nuk ishte ngritur **Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për periudhën e auditimit**, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, në pajtim me detyrimet e neneve 8, 10 dhe 27 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit "Për MFK".

Kjo mangësi është korrigjuar me Urdhrin e Brendshëm të Avokatit të Popullit, nr. 85, datë 31.08.2012.

2.7. Ende nuk janë hartuar nga institucioni (dhe rrjedhimisht mungon miratimi nga titullari) i **Rregullave dhe procedurave për mbrojtjen e aseteve**, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa "ç" të ligjit nr. 10296.

Theksojmë se nga ana e Nëpunësit Zbatues (Përgjegjësja e Financës zj. Dolores Myrtezai), është hartuar **regjistri i aseteve**, detyrim i paraparë nga kreu III, pika 26 e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik".

Gjithashtu, auditimi vëren se në zbatim të kërkesave të kreut IV, pika 74 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik", janë iniciuar procedurat e inventarizimit të pasurisë dhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 54, datë 05.12. 2011.

2.8. Auditimi konstaton se është hartuar **Kodi Etik** dhe është miratuar nga Avokati i Popullit z. Igli Totozani për këtë njësi të qeverisjes së përgjithshme të audituar, me Urdhrin e Brendshëm nr. 29/1, datë 02.05.2012. Ai është titulluar "Kodi i Sjelljes së mirë administrative në institucionin e A.P".

Nga auditimi i komponentëve të veçantë të sistemit të kontrollit të brendshëm, konstatohet se:

A. Vlerësimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm (organizimi, struktura, kodi etik, drejtimi, plotësia e rregullave të funksionimit, menaxhimi i burimeve njerëzore-rekrutimi etj)

Avokati i Popullit është krijuar si subjekt publik, në bazë të përgjegjësi të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999. Menaxhimi i burimeve njerëzore i referohet Nenit 35 "Personeli i zyrës së Avokatit të Popullit" të ligjit Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.04.2000,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

ndryshuar me ligjin nr .9398, datë 12.05.2005, që specifikon se *"Personeli i zyrës së Avokatit të Popullit bën pjesë në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë. Struktura dhe organika e zyrës së Avokatit të Popullit caktohet nga Avokati i Popullit"*.

Struktura organike operuese është ajo e vitit 2011 dhe është miratuar nga Avokati i Popullit në detyrë, me Urdhrin e Brendshëm nr. 16 prot., datë 01.02.2011 *"Për strukturën dhe organikën e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011"*, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*.

A.P , disponon një **Rregullore te Brendshme të Punës** , e aprovuar me Urdhrin nr. 64, datë 28.05.2008 të Avokatit të Popullit, ku janë përcaktuar detyrat për aparatin dhe punonjësit e tjerë. Nga shqyrtimi i komponentëve të kësaj rregullore me Strukturën referuese që i është disponuar grupit të auditimit të KLSH nga Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës së A.P ,, vërejmë se përshkrimi i detyrave në Rregulloren e Brendshme sipas Organigramës së miratuar me Urdhrin nr. 16, date 01.02.2011 të Avokatit të Popullit, përputhet me detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara në Rregulloren e brendshme të Punës.

Mirëpo , kjo rregullore nuk reflekton detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kërkesat e shkresës së Ministrisë së Financave nr. 6082, datë 16.03.2011 *"Për hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike për implementimin e ligjit nr. 10296"*, që specifikon rishikimin e strukturave menaxheriale për të reflektuar:

-përgjegjshmërinë menaxheriale ;

-linjat e raportimit;

-rastet e delegimit të drejtave dhe detyrave;

-procedurat standarde për menaxhimin e aktiveve; procedurat e brendshme antikorrupsion si dhe sinjalizimit të parregullsive, në reference të nenit 8, germa "ë", të ligjit nr. 10296.

B. Vlerësimi i riskut (a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe a përditësohet, a është i bazuar në analiza etj).

- Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e A.P., ndonëse janë marrë disa masa paraprake, (janë identifikuar 2-3 rrisqe), vërehet se *menaxhimi i rrisqeve pothuajse është fushë e pa hulumtuar, por lypset që menaxhimi të hartojë një strategji për këtë çështje*. Auditimi konstaton se nuk ka një regjistër risqesh, si dhe as një sistem të rishikimit dhe përditësimit të tij. Përveç sa më sipër, A.P , nuk ka të evidentuar, si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

rrjedhim as të analizuara ato, me qëllim menaxhimin e tyre dhe minimizimin e pasojave të tyre në zhvillimet e ardhshme.

A.P, ka vendosur një sistem elektronik për evidentimin e aseteve dhe vlerave materiale fizike.

C. Komunikimi dhe raportimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato).

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, etj. **Rregullat mbi komunikimin dhe raportimin midis strukturave drejtuese nuk janë të shkruara për të përcaktuar këto marrëdhëniet dhe hierarkinë e raportimit, informimit, thirrjes, procedurat, afatet etj., për të cilat duhen ndërmarrë veprime korrigjuese.**

Gjithashtu auditimi rekomandon të merren masat, që në të ardhmen sistemi i IT-së, të pajiset me një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave rezervë me qëllim që, të bëhet e mundur ripërfitimi i të dhënave në rast dëmtimi.

D. Monitorimi (a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuar se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).

Në institucionin e A.P, ka një sistem monitorimi i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis administratës, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtorëve dhe përgjegjësive të sektorëve; personelit, financës dhe protokollit, teknologjisë së informacionit, etj, për mbikëqyrjen e sektorëve që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë.

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit është treguar kujdes mbi zbatimin e kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4, datë 27.1.2011, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", pika 3.6, nënpika 63 "Raportet e monitorimit", ku shprehimisht kërkohet që:

"Nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes qendrore, duhet të paraqesin tek nëpunësi i parë autorizues, brenda datës 28 të muajit pasardhës të çdo tremujori, informacion të detajuar mbi performancën e produkteve të buxhetit 2010 ...Raportet e monitorimit të buxhetit do të publikohen në faqen zyrtare të çdo Ministrie, të cilat do të shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nëpërmjet likut të vendosur".

Konkretisht, janë hartuar **raportet 3-mujore të monitorimit të shpenzimeve buxhetore** dhe këto raporte janë dërguar brenda afateve të përcaktuara në Ministrinë e Financave. Nga ana tjetër, këto raporte monitorimi janë bërë publike në internet, në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit. Auditimi vëren se raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore i janë paraqitur periodikisht MF, ndërsa raporti i monitorimit 12 mujor është dërguar me shkresën nr. 11, datë 09.01.2012.

Çdo transaksion financiar kontrollohet nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Mirëpor, **ky sistem nuk është i pasqyruar në Rregulloren e Brendshme.** Një proces i mirë organizuar monitorimi do të ndihmojë në bërjen e analizave, propozimin dhe marrjen e vendimeve nga organet drejtuese.

Auditimi vëren se mungon një rregullore pune në komunikimet elektronike dhe në kuadër të implementimit të informatizimit të veprimtarisë, për kriteret dhe raportet në shqyrtimin dhe përpunimin e informacionit të disponuar.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

E. Aktivitetet e kontrollit (a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të pa pajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plota, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj)
Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat.

Gjithsesi u konstatua se për procese të veçanta mungojnë procedurat përkatëse specifike, të shpallura e të aprovuara mbi administrimin material të aktiveve, për ruajtjen, mbrojtjen inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, etj.

3. Auditimi i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2011, është mbështetur në objektivat dhe zhvillimin e politikave sociale, programin buxhetor afatmesëm dhe programet e zhvillimit, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në zbatim të ligjit nr. 10355, datë 02.12.2010, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit e Ministrisë së Financave nr. 4, datë 27.01.2011, "Për përgatitjen e Buxhetit"

Për vitin 2011, Avokati Popullit ka dërguar në Ministrinë e Financave Projekt-buxhetin për vitin 2011 me shkresën nr. 103/1, datë 27.08.2010. Referuar analizës bashkangjitur projektbuxhetit, rezulton se nga institucioni në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve, janë mbajtur parasysh kërkesat për nevojat imediateve për periudhat në vazhdimësi.

Mbas përgatitjes së projekt-buxhetit, janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë (Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë dhe Financave, dhe Ministrisë së Financave kërkesat për fonde me këtë strukturë :

Tabela nr.1
Në mijë lekë

Nr.	ART	Emërtimi	Kërkesat për fonde
1	600	Paga	61 100
2	601	Sig. Shoqërore e shëndetësore	7 420
3	602,	MShP. operative	15 000
	605	Kuotë anëtarësie	250
4	231	Investime	6 000
		Totali	89 770

Burimi : Sektori i Financës, A.P ,

Për artikullin 600 "Pagat", kërkesa për këtë fond është parashikuar duke marrë parasysh organikën me 48 punonjës.

Për artikullin 601 (sigurime shoqërore e shëndetësore) është marrë parasysh rritja e kufirit maksimal të sigurimit shoqëror, mbështetur në VKM nr. 477, datë 30.06.2010 "për disa ndryshime në sigurimet shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Për artikullin 602 "shpenzime operative" është mbajtur parasysh dhe tavani ardhur me shkresën nr. 1895/25, datë 29.07.2012, nga Ministria e Financave.

Për llogaritë e tjera parashikimi është bërë duke mbajtur parasysh të gjitha shpenzimet për zërat që bëjnë të mundur plotësimin e nevojave të institucionit për ushtrimin e aktivitetit të tij duke marrë parasysh rritjen e ankesave të qytetarëve dhe mbulimin e gjithë territorit të vendit.

Nga kontrolli i ushtruar për respektimin e afateve të dorëzimit të projektbuxhetit, në Ministrinë e Financave, rezultoi se, janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuar në nenin 17 të ligjit organik të buxhetit dhe pikës C të Udhëzimit 11/1, që është data 31 gusht 2010.

Mbas dërgimit të projekt buxhetit në institucionet përkatëse (Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave), kjo e fundit me shkresë nr. 13879/57, datë 28.12.2010 ka njoftuar institucionin e Avokatit të Popullit për miratimin e buxhetit me ligjin Nr. 10355, datë 02.12.2010, « Për buxhetin e vitit 2011 », si dhe në mbështetje të shkresë së AP nr. 160/1, datë 23.12.2010 dërgon planin buxhetor të detajuar.

Buxheti i miratuar paraqitet si më poshtë :

Tabela nr.2

Në mijë lekë

ART	Emërtimi	Plani
600	Paga	60 500
601	Sig. Shoqërore e shëndetësore	7 000
602, 605	MShP. operative & kuotë anëtarësie	15 670
231	Investime për vitin 2011	1 500
231	Investime (Fond i ngrirë)	1 500
TOTALI		86 170

Burimi : Sektori i Financës, A.P ,

Ministria e Financave (Drejtoria e Investimeve) me shkresën nr. 13879/153, datë 05.01.2011 ka njoftuar Avokatin e Popullit për shumën e investimeve të përfshira në tabelën e investimeve. Drejtoria e Thesarit me shkresën nr. 13879/203, datë 11.01.2011, i dërgon institucionit të Avokatit të Popullit detajimin limit mujor për vitin 2011.

Siç duket dhe nga tabelat, fondet buxhetore të miratuara janë në nivel më të ulët se ato të kërkuara me ndryshimet e bëra brenda zërave me vlerë 3 600 000 lekë më pak (ku peshën kryesore e zë pakësimi i investimeve).

Në zbatim të ligjit nr.10450, datë 14.07.2011 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.10355, datë 02.12.2010, "Për buxhetin e vitit 2011", institucionit të Avokatit të Popullit i është bërë rishikim buxheti.

Me shkresën nr. 14568/118, datë 23.08.2011 ardhur nga Ministria e Financave (Drejtoria e Buxhetit), institucionit Avokatit të Popullit i pakësohet buxheti në artikullin 602 Shpenzime operative për shumën 2 700 000 lekë.

Me shkresën nr. 14568/129, datë 24.08.2011 ardhur nga Ministria e Financave (Drejtoria e Investimeve) drejtuar Avokatit të Popullit njoftohet se i pakësohet buxheti në artikullin 231 "Investime" për 1 000 lekë.

Me shkresën nr.14568/172 , datë 02.09.2011, ardhur nga Ministria Financave.(Drejtoria Thesarit), buxheti pakësohet për shumën 3 700 000 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Nga kontrolli për zbatimin e kriterëve dhe kompetencave për transferimin e fondeve buxhetore rezultoi se, transferimi i tyre në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, është bërë në përputhje me udhëzimet e mësipërme. Transferimet buxhetore të kryera gjatë periudhës objekt kontrolli janë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, sipas argumentimit të plotë të institucionit.

Në zbatim të Ligjit nr. 10355, datë 02.12.2010, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2011" me shkresën e MF nr. 3315/1, datë 17.02.2012, si dhe në mbështetje të shkresës nr. 3/1, datë 01.02.2011 dhe 3/2, datë "Transferim fondi për investime" të Avokatit të Popullit, dërgohet ndryshimi i fondeve për investime në masën 1 500 000 lekë, duke çuar në (fond i ngrirë dhe Pajisje). Ndërsa buxheti për llogaritë ekonomike 600 dhe 602,606 në zbatim të ligjit të sipërcituar, janë bërë sipas shkresave nr. 37, datë 17.02.2011, nr. 52, datë 16.03.2011, nr. 57, datë 12.12.2011 të Avokatit të Popullit.

Sipas akt-akordimeve me Degën e Thesarit dhe raportit të monitorimit të Avokatit të Popullit, dërguar Ministria e Financave me shkresën nr.11, datë 09.01.2012, plani përfundimtar i rishikuar i buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve të detajuara për vitin 2011, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3

Në mijë lekë

Prog.1 Planifikim, Menaxhim, Administrim						
	Emërtimi	Kërkesa PBA 2011	Buxheti 2011	Buxheti rishikuar 2011	Fakti 2011	%
600	Shpenz. pagat	61100	60 500	60 193	55 787	92.7
601	Sig. Shoq.	7 420	7 000	7 000	7 000	100
602	Shpezime operative	15 000	15 000	12 391	11 445	92.4
606	Transfert individë			216	216	100
605	Kuotë antarsie	250	670	670	260	38.8
231	Investime	6 000	3 000	2 000	1 951	92.9
	Shuma	89 770	86 170	82 470	76 660	95.7
602	Ardh. jashte buxh.			2 690	2 690	100
	Shuma	89 700	86 170	85160	79350	92.9

Burimi : Sektori i Financës, A.P ,

Nga analiza dhe kontrolli i këtyre të dhënave rezulton se, treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 93%, me diferencë në vlerë absolute prej 5 810 194 lekë. Arsytet e këtij mosrealizimi janë konkretisht, pagat në masën 93% dhe zëri "Kuotë anëtarësie" në masën 38.8%.

Shpenzimet operative janë realizuar në masën 92.4% dhe janë likuiduar në kohë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve për shërbimet e parashikuara. Artikulli investime është realizuar në masën 97.6% për blerje kompjutera.

Në mënyrë analitike realizimi i shpenzimeve operative për nevojat e institucionit për vitin 2011 paraqitet në tabelën nr. që gjendet në anekset e këtij raporti:

VITI 2012.

Në zbatim të Ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 « Për buxhetin e vitit 2012 » si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 02.03.2011 « Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale », Udhëzimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Plotësues nr. 8/2, datë 08.07.2011, nga institucioni i Avokatit të Popullit është përgatitur projektbuxheti që është dërguar në Ministrinë e Financave brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim, përkatësisht me shkresën nr. 129/1 datë 31.08.2011. Kërkesat për fonde buxhetore janë paraqitur në bazë të kërkesave dhe pasqyrave bashkëngjitur udhëzimit të mësipërm.

Në hartimin e projektbuxhetit institucioni Avokatit të Popullit ka mbajtur parasysh kërkesat për nevojat imediate për periudhën në vazhdimësi, si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr. 19409, datë 01.08.2011, « Tavanet e shpenzimeve buxhetore të PBA-se 2012-2014 ».

Mbas përgatitjes së projekt-buxhetit, janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë kërkesat për fonde buxhetore me këtë strukturë :

Tabela nr. 4

Në mijë lekë

Nr.	ART	Emërtimi	Kërkesat për fonde
1	600	Paga	63,000,000
2	601	Sig.shoq.&shëndetësore	7,600,000
3	602	Shpenzime operative	13,000,000
4	605	Kuote anëtarësie	300,000
5	231	Investime	2,000,000
		Totali	85,900,000

Burimi : Sektori i Financës, A.P.

Për artikullin 600 « Pagat », kërkesa për këtë fond është parashikuar duke marrë parasysh organikën me 48 punonjës.

Për artikullin 601 « Sigurime shoqërore&shëndetësore » është marrë parasysh rritja kufirit maksimal të sigurimit shoqëror, mbështetur në VKM nr. 541 datë 27.07.2011 « Për disa ndryshime në sigurimet shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë ».

Për artikullin 602 « Shpenzime operative » është mbajtur parasysh dhe tavani ardhur me shkresën nr. 119409, datë 01.08.2011, nga Ministria Financave. Ky artikull ka të bëjë me plotësimin e nevojave të institucionit për ushtrimin e aktivitetit të tij duke marrë parasysh rritjen e ankesave të qytetarëve dhe mbulimin e gjithë territorit të vendit.

Nga kontrolli i ushtruar për respektimin e afateve të dorëzimit të projekt buxhetit në Ministrinë e Financave, rezultoi se janë dorëzuar brenda afateve që është data 31 gusht 2011.

Mbas dërgimit të projekt buxhetit në institucionet përkatëse (Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave), kjo e fundit me shkresën nr. 23402/106 ,datë 04.01.2012, ka njoftuar institucionin e Avokatit të Popullit për miratimin e buxhetit në zbatim të Ligjit 10487 datë 05.12.2011 « Për buxhetin e vitit 2012 » si dhe mbështetje të shkresës së Avokatit të Popullit nr. 171/1, datë 16.12.2011 « Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2012 të Avokatit të Popullit », dërgon detajimin e buxhetit për vitin 2012 si më poshtë :

Tabela nr.5

Në mijë lekë

Nr.	ART	Emërtimi	Plani leke
1	600	Pagat	58,061,000
2	601	Sig.shoqerore & shëndetësore	7,350,000
3	602	Shpenzime operative	13,000,000
4	605	Kuote anëtarësie	300,000
		Totali	78,711,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Burimi : Sektori i Financës, A.P ,

Ministria e Financave (Drejtoria Investimeve) me shkresën nr. 23402/144, datë 06.01.2012, ka njoftuar institucionin e Avokatit të Popullit për investimet sipas tabelës :

Tabela nr.6

Në mijë lekë

Nr.	ART	Emërtimi	Plani leke
1	231	Investime (pajisje)	1,500,000

Burimi : Sektori i Financës, A.P ,

Me shkresën me nr.123402/166, datë 06.01.2012 Ministria Financave (Drejtoria Thesarit) dërgon në institucionin e Avokatit të Popullit detajimin e limit mujor për vitin 2012.

Siç duket dhe nga tabelat, fondet buxhetore të miratuara janë në nivel më të ulët se ato të kërkuara me ndryshime brenda zërave me vlerë 5,689,000 lekë më pak (ku peshën më kryesore e zë pakësimi i pagave, sigurime shoqërore, investime).

Nga kontrolli për zbatimin e kriterëve dhe kompetencave për transferimin e fondeve buxhetore rezultoi se transferimi i tyre në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli është bërë në përputhje me udhëzimet përkatëse. Transferimet buxhetore të kryera gjatë vitit 2012 janë miratuar nga Drejtoria Thesarit sipas argumentimit të plotë të institucionit.

Në zbatim të Ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, « Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit », i ndryshuar dhe të VKM nr. 382, datë 20.05.1996 « Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 » i ndryshuar, pas largimit nga funksioni, si dhe në mbështetje të shkresës së Avokatit të Popullit nr.182, datë 29.12.2011, për shumën 277,500 lekë dhe nr.132, datë 03.05.2012 për shumën 296,000 lekë Ministria Financave (Drejtoria Thesarit) miratojnë alokimin e fondeve me shkresat nr.284/2, datë 30.01.2012, dhe shkresën nr.7378/2, datë 21.05.2012, për shumat përkatëse.

Sipas akt rakordimeve, me Degën e Thesarit dhe raportit të monitorimit të Avokatit të Popullit, plani përfundimtar i rishikuar i buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve të detajuara për vitin 2012 si 6/mujor paraqiten në tabelën e mëposhtme :

Tabela nr.7

Në mijë lekë

Llog	Emërimi	Kërkesa PBA 2012	Buxheti 2012	Buxheti rishikuar 2012	Plani 6/mujor 2012	Fakti 6/mujor 2012
600	Pagat	63,000,000	58,061,000	58,061,000	30,200,000	28,687,633
601	Sig.shoq & shendt	7,600,000	7,350,000	7,350,000	3,780,000	3,743,424
602	Shpz.operative	13,000,000	13,000,000	13,000,000	5,360,000	5,273,702
605	Kuote anëtarësie	300,000	300,000	300,000	300,000	253,647
604	Trsf.brendeshme			573,500	573,500	573,500
231	Investime	2,000,000	1,500,000	1,500,000	1,500,000	418,994
	Shuma	85,900,000	80,211,000	80,784,500	41,713,500	38,950,900

Burimi : Sektori i Financës, A.P ,

Në mënyrë analitike realizimi i shpenzimeve operative për nevojat e institucionit për vitin 2012 si 6/mujor paraqitet si më poshtë :



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

4. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet.

A. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Struktura Organizative e këtij institucioni për vitin 2011, është miratuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 16 prot., datë 01.02.2011, "Për strukturën dhe organikën e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011", të titullarit në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005.

Në organikën e Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjithsej 48 punonjës, të strukturuar përkatësisht:

-Avokati i Popullit dhe Kabineti, (gjithsej 5 persona).

-Seksioni i Organeve të Administratës Qendrore dhe Vendore me 8 persona; Nga këto: 1 Komisionier, 6 Ndihmëskomisionerë dhe 1 sekretar-regjistruar.

-Seksion i Shërbimeve të Veçanta, me 7 persona; Nga këto: 1 Komisionierë, 5 Ndihmëskomisionerë dhe 1 sekretar-regjistruar.

-Seksioni i Përgjithshëm, me 7 persona; Nga këto: 1 Komisionier, 4 ndihmëskomisionerë, 1 nënseksioni për fëmijët dhe 1 sekretar-regjistruar.

-Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, me 5 persona; Nga këto: 1 Drejtues - Ndihmëskomisioner, 4 nënkomisioner.

-Sekretari i Përgjithshëm, 1 person;

-Drejtoria e Informacionit, Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë, me 5 persona; Nga këto: 1 Drejtor, 3 shefa sektori dhe 1 arkivist dhe sekretare e sekretarit të përgjithshëm.

-Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës, me 10 persona; Nga këto: 1 Drejtor, 2 shefa sektori, 1 magazinier, 3 shoferë, 2 punëtorë dhe 1 teknik mirëmbajtje.

Kjo strukture organike është zbatuar e pandryshuar edhe për vitin 2012. Për periudhën e auditimit ky numër i programuar i punonjësve ka qenë 48 persona (funksionarë politikë dhe punonjës të shërbimit civil ose jo), nga të cilët, 30 punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe 18 punonjës të kontraktuar funksionarë publikë dhe politikë sipas dispozitave të kodit të punës.

Sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", është përcaktuar se "Numri i punonjësve në organikë, për njësitë e qeverisjes qendrore, është i përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit nr. 10 355, datë 2.12.2010. Këshilli i Ministrave mund të rialokojë numrin e punonjësve rezervë vetëm për institucionet e reja të krijuara me ligj..."

Analizuar, në këtë plan, kanë gjetur zbatim kërkesat e Ligjit nr. 10355, datë 02.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011" si edhe detyrimet që kanë rrjedhur nga shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Ministrisë së Financave nr. 17289 / 41, datë 30.12.2010 "Mbi numrin e punonjësve për vitin 2011" (ku, ky numër është 48 persona gjithsej). Edhe për vitin 2012 është ruajtur i njëjti numër punonjësish, në zbatim të Ligjit nr. 10487, datë 05.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2012" dhe përgjegjësi që burojnë nga zbërthimi i tij, sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Ministrisë së Financave nr. 123475/ 52, datë 04.02.2012 "Mbi numrin e punonjësve për vitin 2012", ku sërish ky numër punonjësish mbetet i pandryshuar,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

gjithsej 48. Për vitin 2011 struktura e miratuar është me 48 punonjës dhe në fakt ka 47 punonjës, kurse për vitin 2012, vijon të mbetet në fuqi struktura dhe organika e miratuar për vitin 2011, me 48 punonjës dhe fakt e plotësuar me 48 punonjës.

- Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %), për vitin 2011 dhe 6/m e parë 2012.

Për punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit për **vitin 2011**, fondi i pagave i planifikuar është në vlerën 60,1 milion lekë. Ky fond i pagave për 48 punonjës të A. P për vitin 2011, mbulohet brenda fondit të përgjithshëm të pagave të miratuara. Janë kryer efektivisht shpenzime për pagat për këtë periudhë në vlef të 55,8 milionë lekë, ose niveli i realizimit të fondit të pagave ishte 92.7 %. Ndërsa, në nivel 6-mujori fondi i programuar i pagave është 30,2 milionë lekë dhe është realizuar për 28,7 milionë lekë, ose në masën 95 %.

Nga auditimi dhe verifikimi i sistemit të pagave dhe shtesave mbi to, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se veprimet e përlogaritjes së tyre janë në mbështetje të VKM nr. 475, datë 13.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë....", i ndryshuar dhe VKM nr. 500, datë 18.07.2003 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Avokatit të Popullit".

Për periudhën e auditimit, listëpagesa e punonjësve janë të rregullta dhe të plotësuara me gjithë ekstremitetet, janë bërë rregullisht ndalesat çdo muaj të detyrimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, dhe tatimit mbi të ardhurat personale, të cilat janë derdhur sistematikisht pranë institucioneve përkatëse duke mos krijuar detyrime të prapambetura. Auditimi vëren se nga ana e zyrës së financës janë kryer rregullisht ndalesat, janë kontabilizuar dhe shlyer ato sipas institucioneve të përcaktuara në dispozitat ligjore. Ndalesat për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, sigurimin suplementar dhe tatimet mbi të ardhurat janë likuiduar rregullisht për ISSH dhe DPT me urdhër shpenzimet respektive. Nga auditimi vërehet se, në pjesën e ndalesave nga pagat janë reflektuar dhe tejkalimet e limitit të shpenzimeve, për përdorimin e telefonave celularë nga punonjësit e institucionit.

Auditimi vëren se janë plotësuar rubrikat e vlerësimit vjetor të punonjësve për vitin 2011 sipas seksioneve dhe stafit mbështetës. ***Për sa sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar.***

Nga auditimi i KLSH konstatohet se ***janë respektuar tavanet e dërguara nga ana e Ministrisë së Financave me shkresën nr. 1895 / 25, datë 29.07.2011 për sa i takon peshës specifike të pagave dhe nivelit të këtyre shpenzimeve si Tavanet të Përgjithshme në kuadër të PBA për vitet 2011-2013, që janë respektivisht si në vijim:***

Tabela nr.9
Në milionë lekë

Shpenzimet	2010	2011	2012	2013
a.Per paga dhe sigurime shoqërore	66	68	71	75
.....				
Totali	87	88	92	96
Pesha specifike e pagave ndaj totalit (në %)	75.9 %	77.3 %	77.2 %	78.1 %



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Burimi : Sektori i Financës, A .P

Niveli absolut dhe relativ i realizimit të Fondit të Pagave, për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.10
Në lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Në %
1	Viti 2011	60,192,585	55,786,960	-4,405,625	92,68
2	6/mujori 2012	30,200,000	28,687,633	-1,512,367	94,99

Burimi: Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës, Sektori i Financës të A.P , -së

Urdhër-Shpenzimet për kalimin e pagave në Degën e Thesarit janë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës justifikues dhe auditimi konstaton se shumatat e pasqyruara në listëpagesa rakordojnë plotësisht me përmbledhëset e borderove, ku janë vërtetuar shpenzimet e pagave për funksion, diplomë, vjetërsi dhe vështirësi. Nga KLSH konstatohen 4 (katër) raste të trajtimit të **punonjësve me vështirësi mbi pagën**, përkatësisht:

Rasti I: për punonjës të IT, është dhënë shtesë mbi pagë sipas trajtimit në pikën 4/1 të VKM nr. 545, datë 11.08.2011, ku cilësohet se zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Ministria e Financës (MF), sipas përshkrimit të pozicioneve të punës, meqenëse në pikën 1 /1 të këtij vendimi, në fushëveprimin e këtij vendimi përfshihet edhe administrata e Avokatit të Popullit. Nga ana e institucionit nuk është kërkuar dhe nuk janë marrë konfirmimet përkatëse për shtesën e dhënë në masën 15 % pranë këtyre autoriteteve shtetërore, deri në datën e mbajtjes së këtij raporti.

Rasti III: -Për punëtorët e pastrimit (2) dhe punonjës të protokollit (1), dhe arkivit (1), sipas Urdhrit të Brendshëm të Avokatit të Popullit nr. 506/2, datë 26.11.2001, bazuar në VKM nr. 726, datë 21.12.2000 dhe shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë (M.SH) , nr. 2903, datë 05.11.2001

Rasti III. Shoferi i Avokatit të Popullit është trajtuar me shtesë për vështirësi bazuar në Ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, neni 2, pika 1 dhe lidhja nr. 1, si edhe VKM nr. 621, datë 08.07.2010, pika 1, germa "dh", ku përcaktohet se "shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin "b", për efekt të ligjit nr. 9584 /2006 dhe 10160/ 2009, trajtohen me shtesë mbi pagë në masën 9500 lekë/muaj.

Tabela e realizimit të elementëve përbërës të pagës, Nr. 11
Në lekë

Nr.	Emërtimi	Realizimi 2011	Realizimi 2012 (6 mujori)
I.	Paga, shpërblime	55,786,960	28,687,633
1	Paga e grupit	6,498,217	3,233,820
2	Paga për vjetërsi	1,814,859	954,655
3	Paga për vështirësi pune	373,785	193,630



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

4	Paga për vështirësi rruge		
5	Paga e pozicionit	45,802,263	24,072,348
6	Raporte mjekësore		
7	Paga për kualifikim	539,524	
8	Paga për orë shtesë		8,722
9	Paga për turne të II dhe III-ta		
10	Paga për ditë feste	335,312	224,458
11	Shpërblime	423,000	
12	Paga për punonjës me kontratë		

Burimi: Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës, Sektori i Financës të A.P., -së

Gjithashtu, nga misioni i auditimit të KLSH konstatohet se janë kryer *pagesa për kualifikime pasuniversitare* për 9 raste, përkatësisht është dhënë shtesë mbi pagë në masën **10 mijë lekë**, sipas Urdhrit të Brendshëm Nr. 111, datë 25.07.2008, të Sekretarit të Përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 475, datë 13.07.2007 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 18.04.2008 të MF, MASH dhe DAP.

Bazuar në përcaktimet e VKM nr. 999, datë 02.07.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 500, datë 18.07.2003 të KM "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të A. P", i ndryshuar, VKM nr. 475, datë 13.07.2007 dhe Udhëzimit nr. 1, datë 18.04.2008 të MF, MASH dhe DAP, është specifikuar se:

"për diplomat master dhe titujt e mbrojtur në institucionet jopublike apo jashtë vendit, e drejta e përfitimit lind në momentin e njohjes së këtyre diplomave. Efektet financiare fillojnë nga data e fillimit të procedurës për njohjen e diplomës nga MASH. -për diplomat e mbrojtura në institucionet publike të arsimit të lartë, e drejta e aplikimit për përfitim lind nga momenti i marrjes së diplomës. Efektet financiare fillojnë nga data e fillimit të procedurës përfitimin e shtesës për kualifikim pranë Drejtorisë/ Sektorit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës".

Duke filluar nga data 1 shtator 2011, kur ka hyrë në fuqi VKM nr. 545, nga ana e sektorit të financës nuk janë dhënë shtesa mbi pagë për kualifikime, sipas përcaktimeve të piks 2 germa "c" të VKM nr. 545, datë 11.08.2011

Tabela e realizimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëmarrësi.

Tabela nr. 12
Në lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Në %
1	Viti 2011	7,000,000	7,000,000		100
2	Viti 2012 -6/m	3,780,000	3,743,424	36,576	99,03

Burimi: Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës, Sektori i Financës të A.P., -së

Tabela e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

Tabela nr. 13
në lekë

Periudha	Sigurime shoq. Shëndetësore	Tatimi mbi të ardhurat	Shuma	Derdhur ne Tatime
----------	-----------------------------	------------------------	-------	-------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

	(1)	(2)	3=1+2	(4)
Viti 2011	4,778,495	5,800,677	10,578,969	10,578,969
Viti 2012	2,427,162	2,888,053	5,315,215	5,315,215

Burimi: Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës, Sektori i Financës të A.P. -së

Nga auditimi me zgjedhje për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, konstatohet se ato janë llogaritur e shlyer konform ligjit nr. 7703, datë 11.05.1998 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet përkatëse dhe ligjit nr. 8483, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshimet. Në listëpagesa e hartuara, është mbajtur kontributi i sigurimeve të detyrueshme dhe suplementare si dhe tatimi mbi të ardhurat.

Nga auditimi i zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", u vërejt se për sa i takon shpërblimit të vitit 2011, është mbajtur tatimi në burim në masën 10% dhe është kryer ndalesa.

C. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore etj.

Me Urdhrin e Avokatit të Popullit, nr. 213 prot. , datë 05.12.2011 u është dhënë 47 punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas listëpagesës, shpërblimi i fundvitit në masën 10,000 lekë, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010, të ndryshuar me VKM nr. 493, datë 07.06.2011 "Për krijimin e përdorimit të fondit të veçantë" dhe pikës 3.5 / 62 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", që përcakton se "Përlllogaritja e Fondit të Veçantë dhe përdorimi i tij, bëhet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Mbi krijimin dhe përdorimin e fondit veçantë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Tabela për krijimin dhe përdorimin e Fondit të Veçantë, nr.14
Në lekë.

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
1	Viti 2011	2,880,952	730,415	2,150,537	25,35
2	Viti 2012	1,500,000			

Burimi: Drejtoria e Personelit, Administratës dhe Financës, Sektori i Financës të A.P. -së

U auditua dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit , për zbatimin e kërkesave të pikës 1 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar, ku përcaktohet se fondi i veçantë në njësitë e qeverisjes së përgjithshme krijohet në masën 5% të fondit pagave.

-Fondi i Veçantë për Institucionin e Avokatit të Popullit, për vitin 2011:

Sipas dokumentacionit të administruar nga ana e A. P, fondi i veçantë është planifikuar në vlerën 2,880,952 lekë, realizuar në vlerën 730,415 lekë ose vetëm për 25.35 %.

Përdorimi i fondit të veçantë për vitin 2011, është kryer sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar, për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

shpërblimet me rastin e Vitit të Ri dhe për ndihma e fatkeqësi. Struktura e përdorimit të tij është si më poshtë:

-Shpërblim me rastin e fundvitit (10 mijë lekë) për 47 punonjës, (urdhërshpenzimi, nr. 213, datë 28.12.2011), shuma 423,000 lekë.

-Shpërblim me rastin e 8 marsit, (shuma 91,415 lekë.

-Shpërblim me rastin e daljes në pension për 1 punonjës I.Ceço, urdhërshpenzimi, nr.228, datë 28.12.2011), shuma 126 mijë lekë.

-Shpërblim vdekje, në 3 raste, A.Shyti, G. Lleshi dhe A.Nepravishta nga 30 mijë lekë secili, urdhërshpenzimi nr.37, datë 20.06.2011),

Për pagesat e kryera nga Fondi i veçantë sipas pikës 12 germa "d", të këtij VKM, për ndihma të menjëhershme, fatkeqësish dhe raste tjera, konstatohet se më parë është kryer transferimi i këtyre shumave në llogarinë buxhetore 606 "ndihma ekonomike për punonjësit", sipas urdhër shpenzimit nr. 228, datë 16.12.2011.

Fondi i veçantë për Institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2012:

Sipas dokumentacionit të administruar nga ana e A. P, limit i fondit të veçantë i dërguar nga ana e Ministrisë së Financave si tregues i planifikuar me shkresën nr. 3132, datë 29.02.2012, në masën 1,5 milionë lekë. Auditimi konstaton se nuk ka asnjë përdorim të kësaj shume për 6-mujorin e parë të këtij viti.

Auditimi mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Gjykatave:

Nga ana e auditimit nuk u konstatua asnjë rast mbi dhënien e shpërblimit në zbatim të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Gjykatave.

5. Mbi administrimin e pronës shtetërore, zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen dokumentimit e vlerave monetare e materiale.

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe në valutë për gjithë periudhën.

Nga kontrolli i dokumenteve dhe ditarit të arkës në lekë, për periudhën objekt kontrolli rezultoi se regjistrimet kontabile janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim, sipas të dhënave të dokumenteve justifikues. Për çdo muaj është kuadruar ditari i arkës dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen e librit të arkës. Për çdo muaj është kryer kontrolli fizik i arkës dhe aktverifikimi i tij është bashkangjitur dokumenteve.

Blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla të likuiduara me pagesat e arkës, janë kryer në përputhje me VKM nr 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nga një komision i ngritur me Urdhrin e Brendshëm të Avokatit nr'07, datë 13.01.2011 për vitin 2011 dhe Urdhrin e Brendshëm të Avokatit nr11, datë 17.01.2012, nr. 44, datë 18.05.2012 për vitin 2012.

Urdhërpagesave u janë bashkëngjitur urdhër prokurimet, procesverbalet, faturat e shitësit dhe fletëhyrjet në magazinë. Vlen të theksohet, se blerjet e vogla me pagesë nga arka, janë shumë të kufizuara.

Gjatë kontrollit të dokumenteve të arkës në valutë për periudhën objekt kontrolli rezultoi si vijon: Për veprimet e arkës në valutë, u kontrollua dokumentacioni në mënyrë të njëpasnjëshme dhe rezultoi se, të gjitha pagesat ishin kryer bazuar në urdhrin e titullarit dhe ftesat e institucioneve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

analoge, bashkëngjitur dhe dokumentet e tjera shoqëruese. Në urdhrat e titullarit janë përcaktuar data e nisjes, e kthimit nga shërbimi, shpenzimet që përfiton nga institucioni si dhe ato shpenzime që merr përsipër pala pritëse.

Nga verifikimi i pagesave të kryera rezultoi se në trajtimin me valutë është zbatuar nga dega e financës legjislativi në fuqi. Llogaritja e dietave është bërë konform VKM nr. Nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" ku janë përdorur valutë e konvertuar në lekë.

b Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën.

Nga kontrolli i njëpasnjëshëm i dokumentacionit të bankës për periudhën objekt kontrolli, rezultoi se dokumentacioni dhe veprimet kontabile janë kryer në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës është bërë në llogarinë 580 "Xhirimi i vlerave monetare", llogari e cila në fund të periudhës paraqitet e mbyllur.

Pagesat e kryera me urdhër xhirimi, janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në ditar dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj.

Kontabilizimi i lëvizjeve të disponibiliteteve në ditarin e shpenzimeve korrent është i saktë. Dokumentet justifikuese që i janë bashkangjitur urdhrave të pagesave janë të rregullta dhe të firmosura nga titullarët. Faturat e blerjes janë tatimore dhe hyrjet në magazinë për mallrat e blera janë kryer brenda datës.

U kontrollua zbatimi i VKM nr. 997, datë 10.12.2010, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit". Llogaritja e dietave është bërë në mënyrë korrekte duke u mbështetur në dokumente të firmosura nga titullari.

U kontrollua gjithashtu zbatimi i VKM nr 343, datë 11.07.2002, "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë" ndryshuar me VKM nr. 864, datë 23.07.2010. në zbatim dhe në mbështetje të këtyre akteve nënligjore kanë dalë urdhrat e brendshëm nr. 1, datë 3.1.2011 "Mbi normat e konsumit të impulseve telefonike" ku përcaktohen limitet për çdo person sipas detyrës dhe kufizimeve buxhetore të vëna për këtë institucion.

Blerjet e mallrave, materialet dhe shërbimet janë kryer në përputhje me dhe VKM nr 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Dokumentet justifikuese për çdo blerje ose shërbim të prokuruar, tregojnë se, është bërë studimi i tregut dhe janë mbledhur ofertat të cilat i janë bashkangjitur procesverbalit të miratimit të çmimit.

c- Inventarizimi i pronës shtetërore.

Për vitin 2011, bazuar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012, është kryer inventari fizik i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe vlerave materiale me Urdhrat e Brendshëm nr prot. 54 datë 05.12.2011.

Të gjitha fletët e inventarit dhe kartelat personale janë plotësuar si në sasi e në vlerë dhe janë të firmosura nga të dy palët. Fletët e inventarit dhe kartelat personale të çdo punonjësi ishin të rakorduar me përmbledhësen e inventarit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Për periudhën objekt kontrolli nuk rezultuan diferenca nga kryerja e inventarit dhe nuk ka nxjerrje të materialeve jashtë përdorimit.

- Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

a- Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit konform Planit Kontabël të miratuar. Kontrolli i veprimeve kontabël regjistruar në ditarin e shpenzimeve të konstatuara dhe në ditarin e veprimeve të ndryshme.

Grupi i kontrollit duke u mbështetur në programin e kontrollit, realizoi auditim të plotë në lidhje me Organizimin e përgjithshëm dhe mbajtjen e kontabilitetit nga ku në përfundim mund të shprehemi se:

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiar edhe të dispozitave ligjore në fuqi dhe mbi këtë bazë janë përcaktuar objektivat e sektorit përkatës për një ndjekje sistematike dhe operative të shpenzimeve buxhetore në përputhje me detyrat e përcaktuara. Veprimet e kontabilitetit regjistrohen sipas parimit të partisë dyfishe dhe dokumentet justifikues bazë, për kryerjen e veprimeve ekonomike në kontabilitet, janë urdhër pagesat, fletë-hyrjet, fletë-daljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat situacionet, etj. të plotësuar konform kërkesave ligjore duke zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Për mbajtjen e kontabilitetit është përdorur programi financiar "Alpha Platinum" në përputhje me dispozitat ligjore dhe Udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përpilimin pasqyrave financiare" të Ministrisë Financave.

Për periudhën objekt kontrolli institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka debitorë të prapambetur apo furnizime ta pa paguara. Tepriat e këtyre llogarive rezultojnë zero.

-Shpenzimet për karburant dhe administrimi i automjeteve.

Në vitin 2011, institucioni ka pasur në përdorim 11 autovetura, ndërsa në vitin 2012, kanë qarkulluar vetëm 7 prej tyre. Në fillim të çdo viti janë hartuar procesverbalet për normativat e harxhimit të karburantit për 100 km për çdo automjet mbi bazën e të cilëve është llogaritur dhe sasia e karburantit që nevojitet për çdo udhëtim.

Sektori i shërbimeve, kryen furnizimin për secilin automjet me karburant duke mbajtur evidencën ditore dhe mujore "Libri i furnizimit me karburant". Nga auditimi i kërkesave të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 rezultoi se nuk u vërejtën mangësi e shkelje. Auditimi vëren se për çdo muaj në bazë të fletë udhëtimeve të secilit mjet, bëhet përlllogaritja përfundimtare e harxhimit të karburantit dhe sipas sektorëve, sipas normativave të konsumit të karburantit për çdo 100 km, për të gjitha automjetet.

Konsumi në total i karburantit për periudhën objekt kontrolli paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.15

Nr.	EMERTIMI	Njësia	VITI 2011	VITI 2012 6/ml
1	Benzol pa plumb	Litra	5 080	1 870
2	Gazoil	"	6 510	3 250
	Totali	"	11 590	5 120

Burimi : Sektori Personelit, A. P



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Nga kontrolli me zgjedhje i bërë dokumentacionit të fletë udhëtimeve për tremujorin e dytë të vitit 2011 dhe tremujorin e dytë të vitit 2012, rezultoi se udhëzimet e mësipërme dhe nuk rezultuan diferenca.

6. DREJTIMET E AUDITIMIT PËR PROKURIMET.

Gjatë auditimit që kryem për realizimin e procedurave të prokurimeve në vitin 2011 dhe 6/mujorin e parë të vitit 2012, në subjektin që audituam, kemi trajtuar këto probleme. Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, ndërtime e shërbime nga subjekti i kontrolluar nga ana e subjektit që auditojmë.

Për hartimin e urdhrave e rregulloreve të brendshme për zbatimin e procedurave të prokurimit. Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse.

Testimin e çmimeve të tregut dhe përlllogaritjen e të dhënave sasiore sipas fondit të vënë në dispozicion.

Hartimin e dokument të tender, kriteret dhe kërkesat për kualifikim.

Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrat të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.

Kontrolli i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave, ndërtimeve e shërbimeve.

a. Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, ndërtime e shërbime nga subjekti i kontrolluar.

Argumentimi i nevojave për karburant, riparimin e automjeteve dhe blerje kompjutrash, është bërë nga përgjegjësi i administratës si për vitin 2011, ashtu dhe për vitin 2012. Për plotësimin e nevojave me këto mallra e shërbime si argument i vetëm është paraqitur vetëm nevojat e një apo dy viteve të mëparshme. Nga sa konstatuam, nuk janë paraqitur kërkesat sipas sektorëve e specialisteve të tyre, duke u mbështetur në nevojat e tyre, argumentimin e këtyre nevojave, përbërësit e elementëve të tjerë, në rastin e riparimeve të automjeteve, përveç pjesëve të këmbimit, duheshin të paraqiteshin shpenzimet e shërbimeve periodike, shpenzimet e montim-çmontim të pjesëve të këmbimit, normativat të përdorimit të lendeve të para dhe konsumit të karburanteve, numrit të automjeteve, gjendjes së automjeteve në përdorim, çmimeve të këtyre mallrave sipas tregut aktualisht. Llogaritja e vlerës ka për qëllim për plotësimin e nevojave reale për punë, shërbime apo mallra si dhe përcaktimin sipas kufijve monetarë të kontratave të përcaktuara në VKM nr.1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, pika 2, e kreut II, "Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit".

Për vitin 2011, Institucioni i Avokati të Popullit në zbatim të kërkesave të Ligjit "Për buxhetin e vitit 2011" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", ka parashikuar shpenzime për blerje mallra e shërbime nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit.

Institucioni Avokati i Popullit, duke vlerësuar kërkesat e pikës 3/d, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, të Kreut I^{re}, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, me shkresën nr. 25, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

24.01.2011, ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2011, në të cilin janë parashikuar blerjet e mallrave e shërbime nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit në 3 raste, në vlerën totale prej 4,691 mijë lekë, duke përzgjedhur si procedurë prokurimi "Kërkesë për propozim", në të 3 rastet e prokurimeve të fondeve. Zgjedhja e kësaj procedure është bazuar në nenin 34, "Kërkesa për propozime", të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", ku shprehet se, Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e kërkesës për propozim për kontrata me vlerë nën kufirin e ulët monetarë.

Diferenca në vlerë, e fondit limit e këtyre tre procedurave të prokurimeve të parashikuar me procedurë "Kërkesë për propozim", me realizimin e procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratë është 176 mijë lekë.

Me shkresën nr. 2, datë 06.01.2012, Institucioni Avokati i Popullit, ka dërguar në APP, regjistrin e realizimit të prokurimeve publike të vitit 2011, ku sipas së cilës, Institucioni Avokati i Popullit, ka realizuar blerje mallra e shërbime të ndryshme nëpërmjet procedurës së prokurimit **në tre raste "Kërkesë për propozim"**, me vlere të kontraktuar prej 4.515 mijë lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 2, datë 20.01.2012, ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, në të cilin janë parashikuar blerje mallra e shërbime për vitin 2012, nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit, ku në dy raste, në vlerën totale prej 3.401 mijë lekë, duke përzgjedhur si procedurë prokurimi "Kërkesë për propozim".

Me shkresën nr. 195, datë 11.07.2012, Institucioni i Avokati i Popullit, ka dërguar në APP, regjistrin e realizimit të prokurimeve publike të 6/mujorit të parë të vitit 2012, ku sipas së cilës, Institucioni i Avokati i popullit, ka realizuar blerje mallra e shërbime të ndryshme nëpërmjet procedurës së prokurimit në dy raste "Kërkesë për propozim", me vlere të kontraktuar prej 3 370 mijë lekë, pa TVSh. Diferenca në vlerë e dy prokurimeve të parashikuar me procedurë "Kërkesë për propozim" për vitin 2012, me realizimin e procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratë është 30,7 mijë lekë.

b. Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.

Nga auditim i tre procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2011, dhe dy procedurave të prokurimit të vitit 2012, lidhur me krijimin e funksionimin të njësisë së prokurimit konstatuam se:

Njësia e prokurimit e ngritur me Urdhrin e Brendshëm Nr. 1, datë 05.01.2011, nuk ka qenë i plotë dhe janë konstatuar mangësi gjatë funksionimit.

Në Urdhrin e Brendshëm Nr.1, datë 05.01.2011, si dhe në Autorizimin Nr. 02, datë 05.01.2011, "Për krijimin e njësisë së prokurimit", është ngritur njësia e prokurimit e cila përbëhet nga Anastas Leka, Arlind Kruja, Dolores Myrtezai dhe Arjan Plasari.

Në këtë urdhër, nuk është përcaktuar emrin e juristit që do jetë në përbërje të kësaj njësie prokurimi konform përcaktimeve të VKM Nr. 1, datë 10.01.2006, Kreu V, "Zhvillimi i Procedurave", pika 1, ku shprehet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Në përbërje e njësies së prokurimit e cila përbëhet nga 3 persona me arsim të lartë, ku njeri prej tyre duhet të jetë jurist.

Me Autorizimin Nr. 02, datë 05.01.2011, ka autorizuar z. Gëzim Lleshi me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, që të organizojë, ndjekë dhe realizojë procedurën e prokurimit të tenderave që do të zhvillohen në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Raporti përmbledhës me objekt "Blerje Karburanti", i datës 03.03.2011, megjithëse është përgatitur, nuk është miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor, ky mosveprim përben shkelje: të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, pikës 4/gj, të kreut V, "Zhvillimi i Procedurave", në të cilin shprehet se: është detyrë e kryetarit të komisionit të vlerësimit që pas 5 ditësh nga komunikimi me ofertuesit, përgatit raportin përmbledhës dhe ia dërgon për miratim, titullarit të autoritetit kontraktor.

Të tre dosjet e dokument të procedurave të prokurimit të kryer në vitin 2011, nuk janë dorëzuar në arshivë me protokoll, të inventarizuara nga njësia e prokurimit, sipas Udhëzimit të APP,DST.

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje karburanti" në vitin 2011, me këto të dhëna:

ë dhëna për tenderin	Kom. I vlerësimit të ofertave	Njësia prokurimit
U. Prok. nr. 17, datë 02.02.2011 F. Limit 2,083 mijë lekë pa TVSH Proc. Prok. "Kërkesë për propozim" Data e zhvillimit tenderit 14.02.2011 Firma fituese "Kastrati" sha me marsh fitimi 14.6 lek/litër për gazoil dhe 15.6 lekë/litër benzinë Data e lidhjes kontratës 17.03.2011 Vlera e kontratës 2,083 mijë lekë	Ervin Karamuco, Kryetar Vladimir Ymeraj Anëtar Iliaz Çeço Anëtar	Anastas Leka Arlind Kruja Dolorez Murtezai Artjan Plasari

Rezultoi: Në Urdhër Prokurimin Nr. 17, datë 02.02.2011, është përcaktuar lloji i procedurës prokurimit, "Kërkesë për propozim" dhe ky prokurim publik të realizohet me mjete elektronike, në vlerën 2.083.268 lekë. Kjo procedurë prokurimi është përcaktuar duke u mbështetur në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu, VI, pika 1, në të cilën shprehet se: Zhvillimi i procedurës "Kërkesë për propozim" përdoret për kontratat nën vlerën e ulët monetare, por mbi 400 mijë lekë, sipas nenit 34, të LPP-së, e cila bën fjalë për rastet kur duhet përdorur procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim".

Observacioni i paraqitur nga Ju për mënyrën e përzgjedhjes së llojit të procedurës së prokurimit sipas kufirit monetar pranohet mbështetur në VKM nr.46, datë 21.01.2009.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Në përlogaritjen e fondit limit, është përcaktuar sasia prej 8 000 litra naftë (D1) dhe 6 000 litra "benzinë pa plumb", sipas nevojave të institucionit. Për këtë sasi karburanti që do blihet nuk janë argumentuar nevojat që ka institucioni për karburante, duke mos u mbështetur tek numri i automjeteve që disponojnë, normativave të karburantit që harxhojnë për çdo automjet dhe planit të lëvizjes së këtyre automjeteve që disponon ky institucion për vitin 2011.

Miratimi i dokumenteve të tenderit është bërë me procesverbal nr. 1, datë 02.02.2011.

Sipas kriterëve të veçanta të përcaktuara në DST (Dokumentet Standarde të Tenderi), operatorë ekonomikë **nuk kanë paraqitur dokumentat, për të vërtetuar se janë kualifikuar në përputhje me seksionin 4, të DT.** Sipas DST, në rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, konsiderohet si kusht për shkualifikim, gjë që nuk ka ndodhur.

Bazuar në procesverbalin e hapjes së tenderit, në sistem kanë hedhur të dhënat e tyre operatorët ekonomikë, "Kastrati" sha dhe "Skënderi G" sh p k, për të dy lot.

Sipas Raportit përmbledhës me objekt "Blerje Karburanti" me datë 03.03.2011, mbi procedurën e prokurimit është klasifikuar në vend të parë, për të dy lotët, Gazoil dhe benzinë shoqëria "Kastrati" sha, për lotin e I-re me objekt "Gazoil, D1" marsh fitimi 14.6 lekë, ndërsa për lotin e II-të "Benzinë pa plumb" me marsh fitimi 15.6 lekë.

Raporti përmbledhës me objekt "Blerje Karburanti" me datë 03.03.2011, nuk është miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor, ky mosveprim përben shkelje të, të VKM Nr .1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, pikës 4/gj, të kreut V, në të cilën shprehet se, është detyrë e kryetarit të komisionit të vlerësimit që pas 5 ditësh nga komunikimi me ofertuesit, përgatit raport përmbledhës dhe ia dërgon, për miratim, titullarit të autoritetit.

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt **"Riparim automjesh" në vitin 2011, me këto të dhëna:**

Të dhëna për tenderin	Kom. I vlerësimit të ofertave	Njësia prokurimit
U.Prok. nr.21, datë 24.02.2011 F.Limit 982.000 lekë pa TVSH Pr.Prok. "Kërkesë për propozim" Data e zhvillimit tenderit 08.03.2011 Firma fituese "Kombinat Servis" Data e lidhjes kontratës 14.04.2011 Vlera e kontratës pa TVSh 806.000 lekë ndërsa me TVSh 967.200 lekë	Ervin Pirani Kryetar Vladimir Ymeraj anëtar Iliaz Ceco anëtar	Anastas Leka Dolorez Murtezai Arlind Kruja Arjan Plasari

Rezultoi : Për përcaktimin e fondit limit është hartuar një listë me emërtimin "Riparim automjesh" për nevojat e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011. Kjo liste e përpiluar nga ndonjë punonjës, pasi nuk dihet kush e ka përpiluar, përmban tip e automjeteve që do të riparohen dhe shërbimet dhe pjesën e këmbimit me çmimet përkatëse, të cilat kanë shërbyer për llogaritjen e fondit limit. Nga verifikimi i çmimeve të pjesëve të këmbimit konstatojmë se ato nuk janë reale dhe se kanë diferenca të mëdha me çmimet në treg si:

Për automjetin tip "Benz", "S 500", amortizatorë i parë, për 1 set çmimi 1000 lekë, amortizatorë II dytë, për 1 set çmimi 1000 lekë, kurse për automjetin tip "fiat Sedici" amortizatorë i parë, për 1 set çmimi 25.000 lekë, amortizatorë i dytë, për 1 set çmimi 30.000 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Duke verifikuar dhe artikujt të tjerë të pjesëve të këmbimit konstatojmë se çmimet e aplikuara për llogaritjen e fondit limit nuk janë real dhe të saktë, çmime të pakrahasueshme me të dhënat e çmimeve të tregut apo të institucioneve shtetërore të specializuara për studimin e çmimeve në treg. Me Urdhrin e Prokurimit Nr. 24, datë 24.02.2011, është miratuar procedura e prokurimit **"Kërkesë për propozim"**, mbështetur në VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II, pikal, paragrafi a, dhe Kreu VI, pikal, germa a. "Zhvillimi I procedurës së "Kërkesës për Propozim" i ndryshuar, duke argumentuar për vlerë e ulët monetare të kontratës që do të lidhet. **Referimi i VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II, pika 1, është i gabuar, pasi sipas VKM Nr. 135, datë 03.02.2008, Kreu II, pika 1, "Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit"**, bëhet fjalë që kjo procedurë do të përdoret për blerjen e mallrave apo shërbimeve të mëposhtme, **që lidhen me protokollin e zakonshëm të institucioneve të larta shtetërore, të përcaktuara në ceremonialin e protokollit të shtetit, si dhe organizimin e veprimtarive apo ceremonive të ndryshme protokollare.**

Miratimi i dokumenteve të tenderit është bërë me procesverbal **nr. 1, datë 05.03.2012. Bazuar në procesverbalin Nr. 2, "Për hapjes e ofertave të procedurës "Kërkesë për propozim", prokurim me mjete elektronike", datë 19.03.2012**, konstatohet se kanë hedhur të dhënat e tyre në sistem dy operatorë ekonomikë e konkretisht : "Kombinat Servis" me ofertë 769.300 lekë dhe "Servis Auto 2000" sh.p.k, me ofertë 799.000 lekë.

Miratimi i procedurës së prokurimit është bërë më datë 19.03.2012 dhe është shpallur fituese shoqëria "Kombinat Servis" që kishte dhe ofertën me vlerë më të ulët në vlerë 769.300 lekë.

Kontrata është lidhur më datë 15.05.2012 në shumën 769.300 lekë, pa tvsh, me afat që riparimet e shërbimet e automjeteve të kryhen brenda vitit 2012. **Pagesat për Shërbimet e automjeteve janë kryer pa hartuar më parë preventivin e punimeve e shërbimeve që do të kryheshin tek automjetet e paraqitura në oficinën e subjektit, e përcaktuar kjo në nenin 8 " Kushtet e Pagesë " të DST. Ky preventiv nuk ndodhet në dosjen e dokumentacionin të likuidimit të situacionit të shërbimit të automjeteve të kryer nga kontraktuesi. Nga 967.200 lekë që ka qenë vlera e kontratës së lidhur është kryer pagesa për 888.120 lekë, me diferencë prej 79.000 lekë, kjo sasi lekësh nuk është shpenzuar për riparimin e automjeteve për vitin 2011.**

Likuidimi i faturave të shpenzimeve për riparimin e automjeteve është kryer sipas Faturave Tatimore Shitje të regjistruara në llogaritë përkatëse në kontabilitet.

-Nuk janë dorëzuar në magazinën e institucionit pjesët e këmbimit të përdorura së bashku me mallrat, për tu magazinuar duke mos zbatuar kështu nenin 10, pika 10,3, "Pjesë e Këmbimit" të Dokument Standarde të Tenderit.

-Autoriteti kontraktor nuk ka ngritur një komision si për hartimin e preventivave për riparimin e automjeteve dhe shërbimet që do kryhen në to, ashtu dhe proces verbal të marrjen në dorëzim të punimeve e shërbimeve të kryera nëpër automjete, sipas DST.

Situacionet e punimeve që janë kryer për riparimin e automjeteve, janë firmosur vetëm nga kontraktor, pa pjesmarjen dhe firmosjen e përfaqësuesve të autoritetit kontraktorë të cilët e kishin detyrim ligjorë të hartonin preventivin e riparimeve dhe shërbimeve që do të kryheshin në çdo automjet sipas përcaktimit të "Dokument Standard të Tenderit". Shërbimet e riparimet e automjeteve nuk janë kryer mbi bazën e kilometrave të përshkruar dhe cilësisë së premtuar nga kontraktor .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Nuk ka argument dhe arsye që të kryhen shërbim mjeteve në intervale kohe kaq të shpeshtë, si ndërrim i vajit hidrolik, vaji kamion, bateri makinash në këto automjete:
Automjeti tip, "Nisën Terrano" me targë, TR 1207 F dhe "Hyundai," Gallopër" me targë, TR 8049 H, ky i fundit ka kryer shërbime tre herë në vitin 2011, ajo që konstatohet se kokat e zbarës së automjetit janë nderuar në intervalin rreth 5 muaj në vlerën 12.000 lek, kokë paraleli copë dy në vlerën 12.000 lekë, gjithashtu dhe vaj kamio, në vlerën 1.600 lekë dhe vaj hidrolik 3.200 lekë, janë kryer në intervali 5 mujor, kur dhe janë kryer më parë shërbimet për eliminimin e rrjedhje vaji, me datë 28.04 .2011, në vlerën 10.000 lekë.

3. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje kompjuterësh", me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. I vlerësimit të ofertave	Njësia prokurimit
U. Prok. nr. 29/2, datë 13.05.2011 F. Limit 3.000.000 lekë pa TVSH Pr. Prok. "Kërkesë për propozim" Data e zhvillimit tenderit 26.05.2011 Firma fituese Lot I-rë "Info System" Vlerë 1.389.100 lekë. Firma fituese Lot II-të "Info System" Vlerë 236.970 lekë. Data e lidhjes kontratës Lot I-rë 14.07.2011 Vlera e kontratës 1 389.100 lekë Data e lidhjes kontratës Lot II-të 14.07.2011 Vlera e kontratës 236.970 lekë. Tenderi I Lot. III-të është anuluar, pasi subjektet e paraqitura nuk plotësojnë specifikimet teknike.	Ervin Karamuco Kryetar Vladimir Ymeraj Anëtar Iliaz Çeço Anëtar	Anastas Leka Arlind Kruja Dolorez Murtezai Artan Plasari

Rezultoi: Në llogaritjen e fondit limit për plotësimin e nevojave të këtij institucioni me pajisjet elektronike si : 2 copë kompjuter , 5 copë printer , 2 fotokopjeve, autoriteti kontraktor , Përgjegjësi i Sektorit të Informatikës nuk ka dokumentuar dhe pasur parasysh çmimet e këtyre artikujve të botuar nga INSTAT-i, ose/dhe çmimet e tjera zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse, çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme, çmimet ndërkombëtare të botuara.
-Mos zbatimi i këtyre kritereve në llogaritjen e vlerës limit të kontratës përben shkelje të pikës 2, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 "Llogaritjes së vlerës së kontratës" e përcaktuar në Kreun e II "Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit" argumentuar të dhëna për çmimet e këtyre pajisjeve, nuk ka të dhëna për studimin e tregut për çmimet e këtyre artikujve , ose të dhëna nga institucionet e tjera shtetërore të specializuara. Auditimi konstaton këtë ndarje në lote, si më poshtë:

Lotin 1,"Blerje Kompjuter" me fond limit 1.612.800 lekë, 5 shoqëri e konkretisht : "Infosoft sistem", "Gjergji Kompjuter "BNT Elektroniks", "Cactus" dhe "Sinteza Co".
Lotin 2,"Blerje Printer" me fond limit 244.800 lekë, 3 shoqëri e konkretisht : "Infosoft sistem", "Gjergji Kompjuter , "ABS"



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Lotin 3, "Blerje Fotokopje" me fond limit 1.142.400 lekë, 4 shoqëri e konkretisht : "Infosoft sistem", "Gjergji Kompjuter "BNT Elektroniks", "Sinteza Co".

Ndërsa me proces-verbalin Nr. 3, datë 02.06.2011 Komisioni i Vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave të prokurimit me mjete elektronike.

Data e lidhjes kontratës, Lot I- rë, është 14.07.2011, Vlera e kontratës 1.389.100 lekë. Data e lidhjes kontratës Lot II-të është 14.07.2011, Vlera e kontratës 236.970 lekë.

Tenderi i Lot. III-të, është anuluar, pasi subjektet e paraqitura nuk plotësojnë specifikimet teknike për aparatet e fotokopjimit. Autoriteti Kontraktorë duhet të merrte masa të menjëhershme që tenderi të përsëritej dhe fondet e vena në dispozicion duhet të përdoshin.

Raportit përmbledhës me objekt "Blerje kompjuterësh " pa datë, nuk është miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor , ky mosveprim përben shkelje të pikës 4/gj, të kreut V, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i cili përcakton që pasi hartohet me shkrim Raporti Përmbledhës i dërgohet për miratim Titullari i Autoritetit Kontraktor .

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt **"Blerje karburanti" në vitin 2012**, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. I vlerësimit të ofertave	Njësia prokurimit
Urdh. Prok. nr. 25, datë 02.02.2012 F. Limit 2.601.000 lekë pa TVSH Ndarë sipas loteve: Lot I, gazoil në vlerë 1.361.000 lekë. Lot II, "benzol pa plumb", 1.240.000 lekë. Pr. Prok. "Kërkesë për propozim", me mjete elektronike. Data e zhvillimit tenderit 14.02.2012 Në tendermoren pjesë dy subjekte, "Kastati dhe "Skenderi G" Firma fituese "Kastrati" sha me marzhe fitimi 15 lekë/litër për gazoil dhe 17 lekë/litër benzinë Data e lidhjes kontratës 09.04.2012 Vlera e kontratës 2.601.000 lekë (pa përfshirë	Erind Pirani Kryetar Vladimir Ymeraj anëtar Anastas Leka anëtar	Dolorez Murtezai Arlind Kruja Merita Sanxhaku Hajredin Hysa

Në përlllogaritjen e fondit limit, është përcaktuar sasia prej 8 000 litra naftë D1 dhe 6 000 litra benzinë pa plumb, sipas nevojave të institucionit. Për këtë sasi karburanti që do blihet, nuk janë argumentuar nevojat që ka institucioni për karburante, duke mbështetur tek numri i mjeteve që disponojnë sipas tip, normativave të karburantit që harxhojnë për çdo automjet dhe planit të lëvizjes së këtyre automjeteve që disponon ky institucion për vitin 2012.

Sipas kriterëve të veçanta të përcaktuara në DST (Dokument Standarde të Tenderi) operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur dokument për të vërtetuar se janë kualifikuar në përputhje me seksionin 4, të DT. Sipas DST, një rastet e mos dorëzimit të një dokumenti konsiderohet si kusht për shkualifikim , gjë që nuk ka ndodhur. Miratimi i dokumenteve të tenderit është bërë me procesverbal nr. 1, datë 02.02.2011. Bazuar në procesverbalin e hapjes së tenderit në sistem , kanë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

hedhur të dhënat e tyre operatorët ekonomike "Kastrati" sha dhe "Skënderi G" ShPK, për të dy lot. Sipas Raportit përmbledhës me objekt "Blerje Karburanti" me datë 03.03.2011, mbi procedurën e prokurimit është klasifikuar në vend të parë për të dy lot Gazoil dhe benzinë shoqëria "Kastrati" sha, për lotin e I-rë me objekt "Gazoil, D1" marsh fitimit 14.6 lekë, ndërsa për lotin e II-të "Benzinë pa plumb" me marsh fitimi 15.6 lekë.

Raportit përmbledhës me objekt "Blerje Karburanti" me datë 03.03.2011, nuk është miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor, ky mosveprim përben shkelje të pikës 4/gj, të kreut V, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, hartohet me shkrim Raporti Përmbledhës i cili i dërgohet për miratim Titullari të Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 123, datë 21.10.2012, Avokati i Popullit, ka dërguar në APP, regjistrin e realizimit të prokurimeve publike, ku sipas së cilës Institucioni i Avokati i popullit, ka realizuar blerje mallra e shërbime të ndryshme nëpërmjet procedurës së prokurimit "Kërkesë për propozim", me vlerë të kontraktuar prej 4 505 mijë lekë me TVSH. Kontrata me shoqërinë fituese "Kastrati" sha është lidhur më datë 04.04.2012, me vlerë totale 2.601.000 lekë, pa TVSh, ose vlera e karburantit me TVSh, është 3.121.200 lekë, me afat brenda vitit 2012.

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Riparim automjete" në vitin 2012, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. I vlerësimit të ofertave	Njësia prokurimit
U. Prok. nr. 30, datë 05.03.2012	Ervin Pirani Kryetar	Dolorez Murtezai anëtar
F. Limit 800.000 lekë pa TVSH	Vladimir Ymeraj anëtar	Arlind Kruja anëtar
Pr. Prok. "Kërkesë për propozim"	Anastas Leka anëtar	Merita Sanxhaku anëtar
Data e zhvillimit tenderit 19.03.2012		Hajredin Hysa anëtar
Firma fituese "Kombinat Servis"		
Data e lidhjes kontratës 15.05.2012		
Vlera e kontratës pa TVSh 769.300 lekë		
ndërsa me TVSh 923.160 lekë		

Rezultoi: Me Urdhrin e Prokurimit Nr. 30, datë 05.03.2012, është miratuar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim", mbështetur në VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu VI, pika 1, "Zhvillimi I procedurës së "Kërkesë për propozim" i ndryshuar, duke argumentuar për vlerë e ulet monetare të kontratës që do të lidhet.

Miratimi i dokumenteve të tenderit është bërë me procesverbal nr.1, datë 05.03.2012.

Bazuar në procesverbalin Nr. 2, "Për hapjes e ofertave të procedurës "Kërkesë për propozim", prokurim me mjete elektronike", datë 19.03.2012 konstatohet se kanë hedhur të dhënat e tyre në sistem dy operatorë ekonomikë e konkretisht "Kombinat Servis", me ofertë 769.300 lekë dhe "Servis Auto 2000", ShPK me ofertë 799.000 lekë.

Miratimi i procedurës së prokurimit është bërë më datë 19.03.2012 dhe është shpallur fituese shoqëria "Kombinat Servis," që kishte dhe ofertën me vlerë më të ulët në vlerë 769 300 lekë.

Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentacionit të paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka mbështetje ligjore në nenin 34, "Kërkesë për propozim" të ligjit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

prokurimit në pikën 1, shprehet se, për zgjedhjen e kësaj procedure prokurimi kërkohen të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomik, i ndryshuar në ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007 . Kontrata është lidhur më datë 15.05.2012 në shumën 769.300 lekë , pa t v sh, me afat brenda vitit 2012, me afat që riparimet e shërbimet e automjeteve të kryhen brenda vitit 2012. Pagesat për Shërbimet e automjeteve janë kryer pa hartuar më parë preventivin e punimeve e shërbimeve që do të kryheshin tek automjetet e paraqitura në ofiçinën e subjektit, e përcaktuar kjo në nenin 8, " Kushtet e Pagesë " të DST. Ky preventiv nuk ndodhet në dokumentacionin e likuidimit të situacionit të shërbimit të kryer nga kontraktuesi. Nga 967.200 lekë që ka qenë vlera e kontratës së lidhur është kryer pagesa për 888.120 lekë, me diferencë prej 79.000 lekë, kjo sasi lekësh nuk është shpenzuar për riparimin e automjeteve për vitin 2011. Në dosjen e dokument të arshivuar për prokurimin e fondeve për "Riparim automjeteve" nuk ka emërim me shkrim të një personi ose post organizativ që do të ndjekë çështjen e ekzekutimit të kontratës, mos caktimi i një personi për ekzekutimin e kontratës, përben shkelje të Nenit 31, "Përfaqësimi i Palëve" të Dokument Standard të Tenderit ,(DST).

c. Kontrolli i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave, ndërtimeve e shërbimeve.

Kontrata për blerjen e karburantit me shoqërinë fituese " Kastrati" sha, është lidhur më datë 17.03.2011, me vlerë totale 2,083,268 lekë, me afat brenda vitit 2011. Sipas Urdhër Shpenzimit Nr. 57, datë 23.03.2011 është kryer likuidim i Faturës Tatimore shitje, Nr. 35, datë 17.03.2011, për 8.600 litra gazoil me vlerë 1.453.228 lekë dhe Faturën Tatimore shitje Nr. 36, datë 17.03.2011, për 6.630 litra benzol, me vlerë 1.044.357,6 lekë . Kjo sasi është bërë hyrje në magazinë. Autoriteti Kontraktor para pagimit të faturës ka paraqitur sipas buletinit të APP të datës 14 mars 2011, duke dokumentuar e kontrolluar përqindjet e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Ruters ,lëvruar sipas kushteve CIF- Shqipëri .

Janë lidhur dy kontrata me subjektin "Infosoft sistem" sha, fitues i tenderit për blerjen e kompjuterëve dhe printerave, të ndarë sipas loteve. Procedura e prokurimit të fondeve për blerjen e kompjuterëve dhe printerave ishte kryer me mjete elektronike dhe nuk janë audituar nga grupi i auditivit..

Kontrata për blerjen e kompjuterëve me vlerë 1.389.100 lekë, është realizuar në vlerën 1.389.100 lekë, ndërsa për kontratën për blerje e printer me vlerë 236.970 lek është realizuar 236.970 lek, në total vlera e kontratave që është realizuar është 1.626.070 lekë.

Sipas Urdhër -Shpenzimit Nr. 165, datë 06.09.2011, është bërë likuidimi i faturës Nr. 19557447, datë 31.08.2011, të subjektit "Infosoft sistem" sha, në vlerën 1.626.070 lekë pa TVSh dhe 1.951.284 lekë, me TVSh. Bashkëngjitur Urdhër -Shpenzimi janë dokumentacioni i nevojshëm për likuidimin e faturave të paraqitura nga subjekti, të cilat janë marre në dorëzim sipas Akt- Dorëzimit të mbajtur nga përfaqësuesit e palëve me datë 31.08.2011.

Për vitin 2012, Avokati i Popullit në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10190, datë 26 .11.2009 , "Për buxhetin e vitit 2012" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2012", ka parashikuar shpenzime për blerje mallra e shërbime nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

Avokati i Popullit, duke vlerësuar kërkesat e pikës 3/d të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, të Kreut I^{rë}, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, me shkresën nr. 52, datë 12.03.2010, ka hartuar regjistrin e prokurimeve publike, në të cilin janë parashikuar blerje mallra e shërbime nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit në 3 raste në vlerën totale prej 4 611 mijë lekë, duke përzgjedhur si procedurë prokurimi "Kërkesë për propozim".

Sipas Urdhër Shpenzimit Nr. 125, datë 10.07.2012 është kryer likuidimi i faturës Tatimore shitje Nr. 16, datë 09.05.2012, për 500 litra gazoil me vlerë 95.225 lekë dhe 1500 litra benzol me vlerë 269.400 lekë, kjo sasi është bërë hyrje në magazinë, por fatura e flet-hyrjes nuk është firmosur nga magazinieri.

Sipas faturë Nr. 16, datë 09.05.2012 çmimi I blerjes karburantit, të karburantit Loti I-rë, gazoil është 186.45 lekë/litër ndërsa i benzinës pa plumb është 179.6 lekë/litër.

Autoriteti Kontraktor, para pagimit të faturës ka dokumentuar e kontrolluar përqindjet e rritjes apo të uljes, të çmimit të bursës, sipas Ruters, lëvruar sipas kushteve CIF- Shqipëri. Autoritet Kontraktor ka autorizuar Z. Gjergj Teneqexhiu, me detyrë Sekretarë i Përgjithshëm, që të ndjekë dhe realizojë procedurat e prokurimit të tenderëve.

Ju lutemi, merrni masa që Projekt raporti i Auditimit, t'ju komunikohet të gjithë personave të interesuar të përmendur në të, në mënyrë që të ketë mundësinë, të paraqesin brenda afatit të mësipërm shpjegimet dhe vërejtjet e tyre.

Trajtimi i observacioneve: nga ana e subjektit të audituar, nuk u paraqit asnjë observacion me shkrim brenda afatit zyrtar (7 ditë nga data e dorëzimit të aktverifikimeve). Me shkresën nr. 203/7, datë 08.10.2012, nga personat përgjegjës është bërë deklarimi me shkrim se për 6 akt-verifikimet e mbajtura nga KLSH, jemi dakord dhe nuk kemi vërejtje.

KOKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

1. Nisur nga fakti se, struktura organizative ekzistuese nuk ka mbajtur parasysh kërkesat e kreut II, neni 8 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ku përcaktohet se titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë si detyrim "miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre", rekomandojmë që:

Të përmirësohet struktura organike dhe rregullorja e brendshme (e cila është miratuar më 28 maj 2008), duke rivendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion në administratën e Avokatit të Popullit, linjat e raportimit, rastet e delegimit të të drejtave dhe detyrave, procedurat e brendshme antikorrupsion e të sinjalizimit të parregullsive, raporte të studiara midis numrit të punonjësve në procesin vendimmarrës dhe administratës mbështetëse dhe shtuar pozicionin e auditimit të brendshëm, trajtuar në faqet 10-15 të Raportit të Auditimit.

Shkurt 2013



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT TIRANË".

pajiset me një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave rezervë me qëllim që, të bëhet e mundur ripërfitimi i të dhënave në rast dëmtimi, trajtuar në faqet 10-15 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

3. Nisur nga fakti se, për punonjësin e ngarkuar me IT është dhënë shtesë mbi pagë pa marrë aprovim paraprak sipas cilësimeve të VKM nr. 545, datë 11.08.2011, *rekomandojmë që:*

T'i kërkohet Departamentit të Administratës Publike konfirmimi mbi dhënien e shtesës mbi pagë në masën 15 % për punonjësin e IT, sipas detyrimit të pikës 4/1 të VKM nr. 545, trajtuar në faqet 20-25 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

4. Në zbatim të neneve 10 dhe 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08. 07. 2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", institucioni i Avokatit të Popullit të identifikojë risqet, të hartojë Regjistrin dhe Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve dhe të zhvillojë një procedurë efçente për evidentimin, analizën dhe menaxhimin e risqeve, sipas prioriteteve dhe drejtimeve, trajtuar në faqet 10-15 të Raportit të Auditimit.

Për çdo vit

5. Institucioni i Avokatit të Popullit të marrë masa për të hartuar e aprovuar procedurat përkatëse dhe rregulla specifike për administrimin material të aktiveve, për ruajtjen, mbrojtjen, inventarizimin dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, etj., trajtuar në faqet 10-15 dhe 25-28 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

6. Nisur nga fakti se, punonjësit e caktuar me zhvillimin e prokurimeve publike nuk janë trajnuar për periudhën që është audituar, *rekomandojmë që:*

Të merren masa që personat e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor për të zhvilluar procedurat e prokurimeve elektronike, të marrin pjesë në trajnimet që organizon dhe zhvillon APP-ja, të paktën një herë në vit, trajtuar në faqet 28-37 të Raportit të Auditimit.

Vazhdimisht

7. Nisur nga fakti se, gjithë dosjet e prokurimit të vitit 2011 nuk janë arshivuar, *rekomandojmë që:*

Të realizohet plotësimi i dosjeve të prokurimeve, të inventarizohen ato dhe të bëhet dorëzimi i tyre me procesverbal në arshivën e institucionit nga njësia e prokurimit, trajtuar në faqet 28-37 të Raportit të Auditimit.

Janar 2013

8. Të hartohet dhe miratohet një sistem monitorimi bazuar në raportet periodike mbi treguesit themelore, dhe përgjegjësitë e çdo hallke menaxheriale dhe seksioni, me qëllim analizën e veprimtarisë dhe mbajtjen nën kontroll të treguesve, trajtuar në faqet 10-15 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT